



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

DEKLARATA E POLITIKAVE PRIORITARE
AFATMESME 2014-2016

5 prill 2013

Përmbajtja

HYRJE.....	4
I. PRIORITETET E PERGJITHSHME.....	6
II. PRIORITETET SEKTORALE.....	9
1. RRITJA EKONOMIKE	9
1.1 Tregtia, promovimi i investimeve dhe industria.....	9
1.2 Zhvillimi i sektorit të bujqësisë	11
1.3 Krijimi i mundësive për punësim	13
1.4 Transporti.....	14
1.5 Energjia, minierat, telekomunikimi dhe ndërmarrjet publike	15
2. QEVERISJA E MIRË.....	18
2.1 Administrata publike	18
2.2 Politikat për administratën në nivel lokal.....	19
2.3 Politikat kundër korrupsionit	19
2.4 Të Drejtat e Njeriut	20
2.5 Menaxhimi i financave publike	20
SUNDIMI I LIGJIT DHE SIGURIA	22
3.1 Drejtësia	22
3.2 Fuqizimi i zbatimit të ligjit.....	24
3.3 Mbrojtje dhe siguria	26
4. Integrimet Evropiane, politika e jashtme dhe anëtarësimi në institucionet ndërkombëtare	27
4.1 Integrimet Evropiane.....	27
4.2 Politika e jashtme	28
5. Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor.....	29
5.1 Arsimi	29
5.2 Kultura, rinia dhe sporti	32
6. SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE.....	33
6.1 Shëndetësia	33
6.2 Mirëqenia sociale.....	35
6.3 Mbrojtja e mjedisit jetësor.....	37
8. Diaspora.....	38
9. Kthimi dhe komunitetet.....	39

LISTA E SHKURTESAVE

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për tregti të lirë
DPPA	Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme
DANIDA	Agjencia Daneze Ndërkombëtare e Zhvillimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-së në Kosovë
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MIE	Ministria e Integritit Evropiane
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MeD	Ministria e Diasporës
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFSK	Ministria e Forcë së Sigurisë së Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja për Stabilizim-Asocim
NP	Ndërmarrje Private
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RAPEX	Sistemi i shpejt alarmues për produkte jo-ushqimore

TIK	Telekomi i Kosovës
TVK	Trupat e Vlerësimit te Konformitetit
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
USAID	Agjencia e Shtetet të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

HYRJE

Deklarata e Politikave Afatmesme Prioritare përcakton kornizën e politikave dhe projekteve të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës planifikon t'i zbatojë gjatë periudhës së ardhshme afatmesme 2014-2016. Ky dokument do të jetë mekanizmi kryesor i cili do të udhëzojë Qeverinë në planifikimin e buxhetit të Kosovës dhe në orientimin e burimeve të tjera buxhetore për periudhën e ardhshme tre vjeçare. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016 është dokumenti kryesor që bën ndërlidhjen mes politikave dhe prioritetëve qeveritare me planin buxhetor të vendit.

Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme (DPPA) 2014-2016 përcakton politikat ekzistuese dhe të reja në fushat kyçe për zhvillimin e vendit, të cilat ndërlidhen me objektivat e Qeverisë në aspektin fiskal, ekonomik dhe social. Ky dokument planifikues është hartuar nga Zyra për Planifikim Strategjik nën mbikëqyrjen e Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik dhe në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera të fushave përkatëse të cilat kanë ndihmuar me propozime dhe informata rreth politikave ekzistuese dhe prioritetëve të tyre për periudhën 2014-2016. DPPA paraqet një bazë të qartë dhe progresive mbi zhvillimin e punës së Qeverisë drejt arritjes së objektivave të përcaktuara me programin e miratuar në vitin 2011.

Zbatimi i politikave prioritare të paraqitura në DPPA për vitet 2014-2016 do të kryhet nëpërmjet burimeve të buxhetit të cilat mbulohen nga të hyrat tatimore dhe të hyrat jotatimore të prezantuara në Kornizën Makro-fiskale 2014-2016. Fillimi i implementimit të rregullës fiskale, e cila nga viti 2014 e tutje kufizon deficitin e Buxhetit të Kosovës në 2% të BPV-së, si dhe rritja e kufizuar e të hyrave të përgjithshme në harmoni me rritjen ekonomike kërkon maturi të shtuar në përfshirjen e politikave të reja në kuadër të kornizës buxhetore. Në kornizën buxhetore përfshihen edhe kreditë e kontraktuara dhe të negociuara me IFN dhe si të tilla janë përfshirë brenda kufijve të prezantuar buxhetorë.

DPPA është dokument i cili definon politikat afatmesme dhe vendos prioritetet qeveritare për periudhën afatmesme 2014-2016 e jo vetëm gjatë vitit 2014. Dokumenti synon të përcaktojë edhe politikat të cilat kërkohen të financohen nga burime të ndryshme duke përfshi donatorët, partneret e tjerë zhvillimorë apo edhe format e përziera të financimit (PPP) të cilat nuk janë identifikuar ende gjatë tri viteve të ardhshme ose që do të fillojnë brenda tri viteve të ardhshme.

DPPA gjithashtu parasheh politika dhe projekte të cilat mbështeten nga ana e donatorëve dhe burimeve të tjera alternative, si financimi nga ana e sektorit privat apo forma të kombinuara të financimit. Politikat të cilat nuk mund të mbulohen nga korniza aktuale e paraparë buxhetore do të jenë orientim për burimet tjera financiare alternative dhe ende të paplanifikuara.

Implementimi i politikave të parapara me Deklaratën e Politikave Afatmesme Prioritare të Qeverisë do të krijojë kushte për reformat e domosdoshme në sektorë të caktuar, nëpërmjet të cilave do të bëhet plotësimi i parakushteve ekonomike, sociale dhe institucionale për përafrimin e Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian, NATO-në dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë.

Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme përbehet nga pjesa e prioriteteve të përgjithshme dhe pjesa e politikave specifike sektorale dhe nënsektorale. DPPA përmban shtojcën e cila reflekton politikat dhe projektet sektorale dhe nënsektorale në formë tabelore duke identifikuar edhe institucionet përgjegjëse.

I. PRIORITETET E PËRGJITHSHME

Deklarata e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë për periudhën 2014-2016 është përmbledhur në këto katër fusha kryesore:

1. Rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
2. Qeverisje të mirë dhe fuqizim të sundimit të ligjit;
3. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
4. Rritje të mirëqenies sociale dhe shëndetësore.

Prioriteti kryesor i Qeverisë vazhdon të jetë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe institucional i Republikës së Kosovës. Qeveria sipas prioriteteve të saj do të vazhdojë të financojë brenda kornizës buxhetore 2014-2016 këta sektorë: infrastrukturë publike, energji, bujqësi, reformat në sektorin e rendit dhe sigurisë, shfrytëzimin më efikas të resurseve financiare në arsim dhe reformën e administratës publike si dhe shëndetësi e mirëqenie sociale.

Financimi i prioriteteve afatmesme të paraqitura në këtë dokument parashihet të bëhet nga Buxheti i Kosovës në kuadër të kornizës makro-fiskale që siguron stabilitet makro-fiskal. Gjithashtu, është paraparë të ofrohet mbështetje në realizimin e këtyre prioriteteve edhe nga partnerët zhvillimorë nëpërmjet formave të ndryshme.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar të investojë në implementimin e projekteve që mundësojnë përmirësimin e **infrastrukturës publike** dhe do të vazhdojë ta trajtojë atë si prioritet edhe gjatë periudhës afatmesme. Prioritet do të ketë përfundimi i Rrugës 7, vazhdimi i ndërtimit të Rrugës 6 – Segmenti Lipjan-Hani i Elezit për periudhën e ardhshme afatmesme si dhe vazhdimi i punimeve në zgjerimin e rrugëve nacionale.

Qëndrueshmëria buxhetore dhe stabiliteti makro-financiar do të jetë parimi kryesor dhe do të mbizotërojnë ndaj secilit prioritet gjatë vendosjes së politikave dhe projekteve. Prandaj për politikën e reja kërkohet që të zbatohet **parimi i ri-prioritizimit brenda sektorëve dhe organizatave buxhetore** gjatë procesit të planifikimit buxhetor ose të gjenden burime alternative të financimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik do të fokusohet në **krijimin e një klime të favorshme për investime private**, si vendore ashtu edhe të huaja, për të promovuar rivitalizimin ekonomik dhe industrial. Qeveria gjithashtu do t'i kushtojë vëmendje të veçantë edhe tërheqjes dhe krijimit të mundësive për **investime nga diaspora**.

Sektori i bujqësisë ka rëndësi të veçantë si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Prandaj Qeveria do të vazhdojë të mbështesë sektorin e bujqësisë. Mbështetja e sektorit të bujqësisë do të bëhet nga burime të ndryshme të financimit, përfshi buxhetin, donatorët, kreditë, etj.

Në **mbështetje të rritjes së punësimit** do të vazhdohet me politikat ekzistuese që kanë të bëjnë me reformimin dhe modernizimin e shërbimeve publike të punësimit duke vënë fokusin në ngritjen e kapaciteteve fizike dhe metodologjike, zgjerimi i masave aktive të tregut të punës, duke u fokusuar në nxitjen e punësimit të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, femrave. Në pajtim me Letrën e Qëllimit të mirë me FMN-në do të definohet mekanizimi rregullativ përmes së cilit do të bëhet përcaktimi i pagës minimale në përputhje me faktorët relevant që përcaktojnë pagën minimale si dhe do të bëhet rishqyrtimi i Ligjit të Punës në aspektet që kanë të bëjnë me punësimin e femrave.

Në mesin e prioriteteve të tjera të Qeverisë do të përfshihen edhe furnizimi i sigurt, i qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë me **energji**, përmes tregut konkurrues të integruar në sistemet rajonale dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare, krijimi i mjedisit të favorshëm ligjor dhe rregullator. Kjo do të rezultojë me uljen e subvencioneve për import të energjisë elektrike krahas përmirësimit të vazhdueshëm të performancës në KEK. Gjithashtu pritet të punohet në nxitjen e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe **përpunimit të resurseve minerale**.

Qeverisja e mirë si prioritet i rëndësishëm synohet të arrihet përmes reformave në administratën publike dhe krijimit të një shërbimi civil jo-politik, profesional, i bazuar në merita dhe i menaxhuar mirë, duke u fokusuar në modernizimin e administratës publike, zbatimin e pakos legjislative që ndërlidhet me reformën e administratës publike, me theks të veçantë zbatimit të legjislacionit të miratuar për shërbimin civil dhe paga të shërbyesve civilë. Gjithashtu do të vazhdohet të mbështetet përmirësimi i kushteve të punës përmes zgjerimit të hapësirave të punës për administratën publike.

Drejtësia, rendi dhe siguria do të jenë prioritet i Qeverisë për periudhën e ardhshme afatmesme. Politikat e Sektorit të Sigurisë do të bazohen në strategjinë e re për Sigurinë. Qeveria e Kosovës do të vazhdojë në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të rendit dhe sigurisë si në furnizimin e Policisë së Kosovës me mjete teknike të nevojshme, pajisje teknologjike për shkëmbimin e informatave si dhe me reformat e iniciuara dhe forcimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës, në veçanti në fushat që kanë të bëjnë me hetimin dhe zbulimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sistemi i drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e legjislacionit të ri të miratuar brenda kufirit të paraparë buxhetor dhe me ndihmën e asistencës së jashtme.

Po ashtu, do të vazhdohet me politikat qeveritare që sigurojnë një sistem tatimor të thjeshtë dhe i cili mundëson ruajtjen e stabilitetit të financimit në sektorin publik dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit privat. Prioritet tjetër i Qeverisë do të jetë ngritja e cilësisë së shërbimeve duke shfrytëzuar kapacitetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, e cila do të bëjë të mundur ndërtimin dhe zhvillimin e sistemeve me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në grumbullimin e të hyrave nga ATK-ja dhe Dogana, si dhe zhvillimi dhe avancimi i mekanizmave për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e rasteve të shpëlarjes së parave, korrupsionit, mashtrimit dhe konfliktit të interesit, me qëllim që ky proces të ndihmojë në parandalimin dhe formalizimin e ekonomisë joformale në Kosovë.

Politikat e planifikuara në kuadër të këtij prioriteti strategjik **për zhvillimin e kapitalit njerëzor synojnë ngritjen e cilësisë së burimeve njerëzore**, me qëllim të përshtatjes më të mirë me kërkesat e tregut të punës. Bartës të kësaj fushe janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe

Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet e tjera përkatëse. Këto institucione si prioritet kanë sigurimin e arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit gjatë arsimit të obliguar, si dhe inkurajimin e të nxënit gjatë gjithë jetës. Fokus i veçantë i kushtohet arsimit të lartë, duke mos lënë anash zhvillimin cilësor dhe profesional të mësimit në përputhshmëri me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Zbatimi i këtyre politikave do të bëhet nëpërmjet riprioritizimit të politikave të arsimit dhe duke vazhduar në kuadër të kufirit të deritashëm buxhetor.

Fushat prioritare nëpërmjet të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës synon të forcojë **kohezionin social** dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë të barabartë në jetën publike të vendit janë: politikat sociale (skemat sociale, pensionet, përkrahje për invalid, familje të dëshmorëve dhe kategori të tjera të luftës). Në planin afatmesëm do të bëhet edhe zbatimi i Ligjit për Veteranet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ligjit për ish të Burgosurit Politikë. Ndërsa pritet zbatimi reformës shëndetësore që siguron përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.

II. PRIORITETET SEKTORALE

1. RRRITJA EKONOMIKE

1.1 . Tregtia, promovimi i investimeve dhe industria

Plani i Veprimit për zbatimin e Vizionit Ekonomik 2011-2014 ka shërbyer si kornizë kryesore strategjike për zhvillimin e politikave të sektorit privat gjatë periudhës së kaluar afatmesme. Për të përmirësuar ambientin e biznesit në Kosovë gjatë viteve të kaluara janë ndërmarrë një sërë reformash politike, legjislativë dhe administrative. Përmirësimet e tilla kryesisht kanë pasur të bëjnë me thjeshtësimin e procedurave të regjistrimit të bizneseve nëpërmjet eliminimit të kërkesave për licenca/leje të punës.

Të arriturat në këtë fushë kanë qenë të konsiderueshme dhe janë vlerësuar në rangimin e Kosovës në Indeksin e të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2013. Në këtë drejtim, përmes veprimeve të ndërmarra në kuadër të politikave të zbatuara deri më sot, Kosova në aspektin e të bërit biznes ka arritur rezultatet si më poshtë:

Mbrojtja e investimeve	76 vende
Fillimi i biznesit	44 vende
Lejet e Ndërtimit	33 vende
Tregtia	9 vende
Energjia elektrike	6 vende

Promovimi i investimeve dhe potencialit për eksport është një ndër prioritetet e sektorit dhe Qeverisë, me ç'rast janë organizuar një mori konferencash dhe panaire të bizneseve, për mbrojtje të investimeve. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore, IHD-të për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2012 janë 86.20 mil.

Disa prej të rezultateve të arritura deri më tani:

- Eliminimi i taksës për regjistrimin për herë të parë të biznesit
- Eliminimi i kërkesës për kapital fillestar për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K) dhe uljen e kërkesës për kapital fillestar për Shoqëritë Aksionare nga 25000 në 10000 euro.
- Eliminimi i lejes së punës dhe inspektimit sanitar.
- Eliminimi i 6 licencave për kompanitë e ndërtimeve
- Shkurtimi i afatit kohor për regjistrimin e bizneseve nga 10 në 3 ditë;
- Shkurtimi i numrit të përgjithshëm të ditëve për fillimin e biznesit nga 59 në 5 ditë;
- Sistemi i regjistrimit të bizneseve i integruar me

Gjatë vitit 2011 janë nënshkruar 2 marrëveshje për mbrojtje të investitorëve ndërsa në vitin 2012 janë nënshkruar edhe dy marrëveshje të tjera. Në ndërkohë, janë iniciuar një numër i marrëveshjeve ku, aktualisht, afër nënshkrimit janë marrëveshjet me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kroacinë. Gjithashtu janë iniciuar marrëveshjet me Britaninë e Madhe, Norvegjinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe një numër të konsiderueshëm të shteteve të tjera. Vlen të përmendet se nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet e BE-se është ndërprerë për shkak të hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Në vazhden e promovimit të turizmit vendor Qeveria është duke punuar në Komplexin e Brezovicës.

Ngritja e cilësisë krijon bazë për konkurrencë në rajon dhe më gjerë. Infrastruktura e cilësisë, përbëhet nga 19 trupa të certifikuar për vlerësim të konformitetit, me ç'rast prioritet do të jetë

rritja e tyre dhe monitorimi/kontrollimi i atyre ekzistues. Zhvillimi i projekteve kapitale, si Parku i Biznesit në Drenas me infrastrukturë përcjellëse, Laboratorët e Ndërtimit dhe Industrisë, Qendra e Panairove, në përgjithësi kanë shkuar sipas dinamikës së paraparë

Prioritetet kryesore për zhvillimin e këtij sektori janë:

Krijimi i një klime të favorshme për investimet private vendore dhe të huaja

Qeveria me qëllim të promovimit të rivitalizimit ekonomik dhe industrial në periudhën e ardhshme afatmesme do të vazhdojë të zbatojë reformat të cilat kanë nisur në drejtim të përmirësimit të ambientit të biznesit si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të rangimit në raportin e Bankës Botërore të të Bërit Biznes. Gjithashtu, do të synohet përfundimi i Parkut të Biznesit, vazhdimi i punës më inkubatorët e biznesit dhe ndërtim i zonave ekonomike.

Përkrahja e NVM-ve mbetet prioritet kryesor i cili ndihmohet edhe nga parterët zhvillimorë dhe ndihma në këtë drejtim pritet edhe në të ardhmen. Ndërsa në anën tjetër, nevoja e qasjes së NVM-ve në financa është shndërruar në prioritet afatmesëm, ku realizimi i kësaj do të fillojë me krijimin e mekanizmave për garantimin e kredisë në pajtim me strategjinë e borxheve. Përcaktimi i 3-5 sektorëve strategjik deri në fund të vitit 2013, ku përparësi do t'i jepet prodhimit dhe eksportit, të cilat do t'i ofrojnë Kosovës bazën për krijimin e përparësive krahasuese me qëllim që Kosova të jetë globalisht konkurruese.

Përkrahja nga donatorët përfshi dy projekte të financuara nga Komisioni Evropian (nëpërmjet IPA 2011 dhe IPA 2013), me vlerë totale të përbashkët prej katër milionë eurosh, të fokusuara në përkrahjen për NVM dhe promovimin e pronësisë industriale.

Promovimi i investimeve dhe eksporteve

Do të vazhdohet me aktivitetet promovuese dhe informuese për promovimin e investimeve duke përfshirë edhe promovimin e potencialit turistik dhe produktet turistike, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit me shtetet tjera relevante në fushën e promovimit të investimeve. Qeveria fokus të veçantë do t'i kushtojë tërheqjes së investimeve nga ana e diasporës kosovare.

Gjatë periudhës së ardhshme afatmesme synohet krijimi i brendit të Kosovës për kualitet “Quality of Kosovo” që ka për qëllim identifikimin e produkteve me cilësi të lartë.

Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së cilësisë

Do të vazhdohet me avancimin e Laboratorëve të Metrologjisë, ku deri në fund të vitit 2015 do të punohet në rritjen e mbikëqyrjes së metrologjisë duke u fokusuar në metrologjinë e arit, energjisë elektrike dhe naftës. Si objektive specifike për periudhën 2012 deri me 2015 është rritja e numrit të Trupave të Vlerësimit të Kosovës (TVK-ve), për 70% deri më 2015. Gjithashtu do të fillohet të punohet në përmirësimin e akreditimit si dhe në shtimin e numrit të standardeve të transpozuar dhe po ashtu do të punohet në zbatimin e tyre.

Siguria e produkteve industriale joushqimore

Ky prioritet parashihet të realizohet nëpërmjet ngritjes së vetëdijes së konsumatorit në shfrytëzimin e sistemit efektiv të adresimit të ankesave që pritet të ndërtohet gjatë vitit 2013 dhe përmes krijimit të bazës të të dhënave konform RAPEX-it për shkëmbimin e informacioneve. Këto do të krijojnë bazën për mbikëqyrjen e tregut

Rishikimi i politikave tregtare

Një prioritet i rëndësishëm me qëllim të përmirësimit të bilancit tregtar të vendit është rishikimi i politikave tregtare që pritet të bëhet deri më 2014 ku do të përfshihet vendosja e një pakete të tillë, që është e shkallëzuar dhe që i stimulon ato të cilat kanë potencial eksportues. Deri në fund të vitit 2015 planifikohet liberalizimi i tregut të pjesës më të madhe të produkteve industriale, me BE-në dhe Turqinë dhe do të shqyrtohet mundësia e arritjes së marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me vendet tjera.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe duke përdorur një model kuantitativ parashihet të bëhet identifikimi i sektorëve prioritarë me kapacitet eksportues. Krahas kësaj pritet të bëhet identifikimi i 3 deri 5 tregjeve potenciale ku kompanitë kosovare do të mund të plasojnë produktet e tyre.

Objektiv tjetër në kuadër të këtij prioriteti është që deri në vitin 2015 të adresohen të gjitha kërkesat për anëtarësim në OBT që do të pasojnë aplikimin për anëtarësim që pritet të bëhet gjatë vitit 2013.

Në përgjithësi realizimi i këtij prioriteti, përveç nga fondet e buxhetit të Kosovës, planifikohet të mbështetet edhe nga programet e Instrumentit të Para-Aderimit.

1.2 . Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë

Sektori i bujqësisë luan një rol të rëndësishëm për ofrimin e mundësive për punësim dhe rrjedhimisht edhe për krijimin e të ardhurave për banorët që jetojnë në zona rurale. Bujqësia si një ndër prioritetet me rëndësi të veçanta të Qeverisë, gjatë këtyre viteve është mbështetur në masë të konsiderueshme nga Qeveria me qëllim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm rural dhe bujqësor. Kjo mbështetje është ofruar nëpërmjet përkrahjes së drejtpërdrejtë për fermerët, industrinë agro-përpunuese, infrastrukturën e ujitjes dhe grupeve lokale rurale. Gjithashtu, në këtë fushë është punuar në përafrimin e politikave kombëtare me politikat e përbashkëta bujqësore të Bashkimit Evropian.

Paraqitje e sektorit të bujqësisë:

- Kontributi në BPV -11% deri 12%
- Punëson 35% të punësuarve të përgjithshëm
- Përbën 16% të eksportit total

Nga 1.1 milionë hektarë të sipërfaqës totale të Kosovës:

- Tokë bujqësore janë 53%,
- Tokë pyjore 41%,

Rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në zona rurale.

Bazuar në vlerësimin afatmesëm të Planit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2007-13, investimet dhe mbështetja e ofruar deri më tani vlerësohet se kanë krijuar 2175 vende të reja të përhershme të punës dhe mbështetje të rreth 10000 vendeve ekzistuese të punës.

Disa tipare që e karakterizojnë bujqësinë në Kosovë janë: prodhimtaria e ulët, fermat e vogla dhe jo të specializuara, mungesa e shërbimeve këshilluese, etj, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në aftësitë konkurruese karshi prodhimeve të importuara.

Si rrjedhim, Qeveria e Kosovës përmes MBPZHR-së, për periudhën 2014-2016, për këtë fushë ka paraparë këto prioritetet:

Rritja e aftësive konkurruese të fermerëve

Ky prioritet pritet të realizohet nëpërmjet rritjes së prodhimtarisë bujqësore si dhe përmirësimit të standardeve të cilësisë së ushqimit, dhe përmbushjes së tyre nga fermerët. Për këtë qëllim, në mbështetje të këtij prioriteti parashihet të vazhdohet me:

- ristrukturimin e fermave bujqësore,
- ristrukturimin e industrisë agropërpunuese
- krijimi i tregjeve dhe deponive për grumbullim, ruajtjen dhe klasifikimin e prodhimeve bujqësore
- intensifikimin e masave për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes.
- pagesat direkte në bujqësi.

Përmes programit të zhvillimit rural dhe pagesave direkte të ndikohet në formalizimin e sektorit

Gjithashtu, në arritjen e këtij prioriteti parashihet një përkrahje e madhe nga partnerët zhvillimorë siç janë: KE përmes IPA 2013, DANIDA, Banka Botërore, dhe USAID, mbështetja e të cilave përqendrohet në rritjen e kapaciteteve prodhuese në bujqësi përmes granteve për fermat dhe ndërmarrjet agropërpunuese, si edhe për rritjen e kapaciteteve njerëzore, sistemeve dhe teknologjike të MBPZHR-së.

Avancimi i shërbimeve këshillimore

Trajnimet dhe bartja e njohurive të fermerët dhe agro-përpunuesit janë synim që pritet të arrihet me realizimin e këtij prioriteti, prandaj ofrimi i shërbimeve trajnuese me qëllim të aftësimit të fermerëve do të vazhdojë edhe gjatë kësaj periudhe me përkrahje edhe nga partnerët zhvillimorë siç është KE-ja me programin e IPA 2013.

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe tokës bujqësore

Në realizimin e këtij prioriteti, përveç masave të vazhdueshme të listuara më poshtë:

- pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura
- krijimit të kadastrës së vreshtave dhe industrisë së verës
- vazhdimin të shërbimeve të komasacionit dhe rregullimit vullnetar të tokave dhe krijimi i vreshtave dhe industrisë së verës,

MBPZHR-ja gjithashtu ka paraparë iniciativë të reja që kompletojnë përpjekjet drejt arritjes së këtij prioriteti. Masat e tilla që nuk janë ndërmarrë më herët janë: mirëmbajtja e pyjeve dhe mbrojtja nga prerjet ilegale, zjarret, erozioni, aplikimi i masave silvikulturore në pyjet e reja.

Zhvillimi i komunitetit rural

Ky prioritet planifikohet të realizohet duke përdorur grupet lokale të veprimit. Qëllimi do të jetë diversifikimi i aktiviteteve të fermës. Përveç financimit nga buxheti i Kosovës, në realizimin e këtij prioriteti parashihet edhe përkrahje nga ana e projekteve të mbështetura nga partnerët zhvillimorë siç janë Qeveria e Gjermanisë dhe Qeveria e Austrisë.

Si politika të reja në kuadër të këtij prioriteti janë: zhvillimi i turizmit rural, krijimi i markave tradicionale të prodhimeve bujqësore dhe përkrahja e punishteve zejtare.

Përmirësimi i sigurisë ushqimore dhe cilësisë së ushqimit.

Rritja e sigurisë së ushqimit vazhdon të mbetet prioritet kryesor i Qeverisë së Kosovës, që pritet të arrihet përmes masave të vazhdueshme për ngritjen e cilësisë së ushqimit. Në këtë drejtim, përafrimi i legjislacionit me rregulloret e BE-së dhe atyre të cilat dalin nga pakoja higjienike mbetet synim kryesor. Përveç kësaj, planifikohet që të rritet cilësia dhe fuqizimi i kontrollit fitosanitar dhe veterinar në vendkalimet kufitare dhe në brendi të territorit të Kosovës. Në lidhje me këto masa parashihet mbështetje nga partnerët zhvillimorë, kryesisht BE-ja përmes projekteve për ngritjen e kapaciteteve të cilat financohen nga IPA 2010. Gjithashtu, në kuadër të programeve IPA 2011, IPA 2012 dhe IPA 2013 do të përkrahët ndërtimi i fabrikës së riciklimit, në vlerë prej 5 milionë eurosh.

1.3 Krijimi i mundësive për punësim

Një nga sfidat kryesore për shoqërinë kosovare është shkalla e lartë e papunësisë. Rritja e punësimit është e lidhur ngushtë me zhvillimin e sektorëve të cilët direkt ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Por zhvillimi i këtyre sektorëve dhe rritja e përgjithshme ekonomike e tanishme nuk ka qenë e mjaftueshme për të zbutur nivelin e papunësisë në Kosovë. Punësimi në Kosovë në përgjithësi është koncentruar në tregti (17%), arsim (13 %), administratë publike (10%), ndërtim (8%), ndërsa në prodhim punojnë rreth 10% të punëtorëve (Raporti i Progresit i KE 2010).

Prandaj përpjekjet për rritjen e shkallës së punësimit lidhen me punën e shumicës së dikastereve të Qeverisë dhe nuk mund të përqendrohen vetëm në një institucion, megjithëse bartëse kryesore e zhvillimit të politikave për punësim mbetet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku prioritetet e saj janë:

Rritja e shkallës së punësimit

Në mbështetje të rritjes së punësimit do të vazhdohet me politikatat ekzistuese që kanë të bëjnë me reformimin dhe modernizimin e shërbimeve publike të punësimit duke vënë fokusin në ngritjen e kapaciteteve fizike dhe metodologjike, si dhe formimi i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pastaj zbatimi i sistemit të SIMP-it, zgjerimi i masave aktive të tregut të punës, duke u fokusuar në nxitjen e punësimit të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, femrave, të papunëve afatgjatë dhe komuniteteve. Gjithashtu, do të fillojë zbatimi i Ligjit mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimeve Publike të punësimit, ngritja e kapaciteteve fizike të Qendrave Rajonale të Aftësisit Profesional (QRAP) dhe furnizimi i kabineteve të trajnimit me mjete dhe pajisje moderne, forcimi i partneritetit publik-privat, blerja e shërbimeve të trajnimeve përmes fondit të trajnimeve dhe kontraktimit të shërbimeve të trajnimit për personat me aftësi të kufizuara, sigurimi i cilësisë së trajnimeve- akreditimi dhe riakreditimi i QAP dhe programeve të trajnimeve si dhe trajnimi i trajnerëve me metodologji të reja sipas Kornizës së Kurrikulit të Kosovës, furnizimi i QRAP me vetura dhe autobusi për qendrën në Prishtinë

Si politika të reja këtu përfshihen themelimi i drejtoratit të aftësimeve profesionale në kuadër të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, stimulimi i ndërmarrësisë sociale si mjet për uljen e papunësisë. Gjithashtu në pajtim me Letrën e Qëllimit të Mirë me FMN-në do të bëhet ruajtja e nivelit aktual të pagës minimale dhe rishqyrtimi i Ligjit të Punë në aspektet që kanë të bëjnë me punësimin e femrave.

1.4 . Transporti

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit është një ndër politikat kryesore të zgjedhura nga Qeveria për të kontribuar në efektet e gjithëmbarshme të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit duke rritur përfshirjen e kapitalit privat në ekonomi.

Krahas përmirësimit të infrastrukturës shfaqet edhe nevoja për shtimin e sigurisë në komunikacionin rrugor që tashmë paraqet një prej objektivave strategjike të këtij sektori. Në drejtim të realizimit të kësaj objektive, Ministria e Infrastrukturës ka ndërmarrë një varg veprimesh dhe masash siç janë:

- ndërtimi i shumë nënkalimeve dhe trotuareve,
- përmirësimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal,
- zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore.

Këto aktivitete kanë ndikuar në uljen e aksidenteve në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu, në ngritjen e sigurisë vend të rëndësishëm ka zënë edhe avancimi i kriterëve të vlerësimit për shofer krahas zhvillimit të infrastrukturës përkatëse.

Rrjeti i hekurudhave përbëhet prej rreth 334 km infrastrukturë hekurudhore. Pjesa më e madhe e rrjetit hekurudhor është në gjendje të mirë. Megjithatë, ky sektor ka nevojë për investime të reja, posaçërisht në mirëmbajtjen dhe në modernizimin e rrjetit ekzistues. Transporti i mallrave është rritur gjatë viteve të fundit dhe pritet të rritet edhe më shumë.

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Cilësia dhe sasia e shërbimeve në këtë aeroport është rritur ndjeshëm. Si pjesë e rrjetit themelor regional dhe ndërkombëtar, mbetet si synim zgjerimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të këtij aeroporti, i cili aktualisht është dhënë me koncesion (LIMAK-LYON).

Prioritetet kryesore për zhvillimin e këtij sektori janë:

Përmirësimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit

Në përgjithësi, të gjitha masat në realizimin e këtij prioriteti janë në drejtim të arritjes së qëllimit për integrimin e rrjetit të transportit në korridoret Pan-Evropiane në harmoni me standardet ndërkombëtare. Në këtë drejtim, fokusimi ynë është në rrjetin rrugor ku si masa kryesore që parashihen për periudhën e ardhshme afatmesme janë:

Transporti rrugor ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë. Në këtë sektor gjatë vitit 2012 janë bërë këto zhvillime:

- Lëshimi në qarkullim i 60.4 kilometrave të autostradës Morinë-Merdare,
 - 25 km të Autostradës që i takojnë segmenteve 7, 8 dhe 9 - do të përfundojnë deri në fund të 2013
- Asfaltimi i 32 km të rrugëve regjionale
- 85 km rrugë lokale.

- Përfundimi i Rrugës 7
- Vazhdimi i ndërtimit të Rrugës 6 – Segmenti Lipjan - Hani i Elezit për periudhën e ardhshme afatmesme.
- Vazhdimi i punimeve në zgjerimin e rrugëve nacionale M9 – Segmenti Gjurgjicë – Kijevë – Udhëkryqi i Klinës. dhe rrugës M2 – Segmenti Milloshevë – Vushtrri.

Gjithashtu Ministria e Infrastrukturës do të përqendrohet në përmirësimin e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve kombëtare. Ndërsa, krahas këtyre parasheh edhe shtrirjen e masave në mënyrat e tjera të transportit siç janë transporti hekurudhor përmes politikës së re për rehabilitimin e linjës hekurudhore Leshak-Hani i Elezit dhe trenit “shuttle” për lidhjen e Prishtinës me Aeroportin.

Për shkak të implikimeve buxhetore në zbatimin e projekteve në infrastrukturën e transportit do të bëhen përpjekje për gjetjen e mundësive alternative të financimit, ku vlen të përmendet kredia e bankës Islamike për rrugën M2.

Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve të transportit dhe siguria në komunikacion

Masat drejt realizimit të këtij prioriteti pritet të rezultojnë me rritje të sigurisë në komunikacion. Ndër të tjera, këto masa përfshijnë edhe krijimin e ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në fushën e transportit, zhvillimi i infrastrukturës kërkon edhe intensifikim të veprimeve kryesore siç është sinjalizimi i rrjetit rrugor dhe fuqizimi i rregullave të komunikacionit. Gjithashtu, planifikohet të vazhdohet me subvencionimin e udhëtarëve në transportin tokësor varësisht nga mundësitë buxhetore për zbatimin e një politike të tillë.

Në mbështetje të realizimit të këtij prioriteti planifikohen politika të reja siç janë: ndërtimi i poligonit për ngasje të sigurt, ndërtimi i objekteve për testimin e kandidatëve për shoferë, po ashtu parashihet krijimi i bazës së të dhënave për patent-shofer, pajisja e inspektoratit me mjete moderne për inspektim, sigurimi i vendkalimeve në hekurudha përmes instalimeve të sinjalizimit.

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare.

Të gjitha masat drejt realizimit të këtij prioriteti shpijnë në arritjen e qëllimit për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare në fushën e transportit. Parashihet arritja e marrëveshjeve në fushën e transportit rrugor, transportit hekurudhor, anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare në fushën e hekurudhave, anëtarësimi në ICAO ADR, ITF, ERTR, INTERBUS.

1.5 Energjia, minierat, telekomunikimi dhe ndërmarrjet publike

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës do të vazhdojë të jenë politikat të cilat i kontribuojnë zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim është punuar në përparimin e kapaciteteve të transmisionit dhe

Disa aktivitete që do të vazhdojnë:

- Përmbyllja e procesit të privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit të KEK-ut (KEDS)
- Bartja e aseteve nga KEK të operatori Calik-Limak
- Investime të konsiderueshme në blloqet e njësive të TC Kosova A.

distribucionit, furnizimit me energji elektrike, rritjes së efikasitetit në shfrytëzimin e resurseve minerale, rritjes së penetrimit të internetit i cili është 38% dhe telefonisë mobile që aktualisht mbulon 75% të vendbanimeve. Mbetet që edhe më tutje të këtë angazhim për përmirësimin e gjendjes aktuale.

Sa i përket sektorit të energjisë dhe kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë nga linjiti, ka vazhduar puna lidhur me ndërtimin e TC Kosova e Re. Ndërkohë, ka një interesim të shtuar të investitorëve privatë për të investuar në projektet e BRE-ve, kryesisht në hidrocentrale të vogla dhe energji të erës, për të cilat projekte Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka lëshuar autorizimet përkatëse. Investimet në gjenerim, mihje, deponi të hirit, djerrina, në zgjerimin dhe ndërtimin e elektrofiltrave statik, transportimin hidraulik të hirit, trajtimin e ujërave industrial, largimin e fenolëve dhe të ujërave fenolik, janë disa nga masat e ndërmarra në përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Projekti për asgjësimin e mbi 20 mijë tonelatave të materieve të rrezikshme që gjendeshin në ish-objektin për Gazifikim është duke u zbatuar dhe do të vazhdojë gjatë periudhës 2014-2016 ashtu si edhe në rregullimin mjedisor të këtyre hapësirave. Të gjitha këto projekte kapin shumën e investimeve prej 50 milionë eurosh - investime vetëm në sektorin e mjedisit.

Sektori i minierave zhvillohet sipas Strategjisë Minerare për periudhën 2012-2025 dhe programi i saj i zbatimit për periudhën 2012-2014. Po ashtu janë kryer studimet e fizibiliteti për pellgun qymyrmbytës të Dukagjinit dhe të Drenicës. Me qëllim të mbrojtjes të burimeve natyrore nga shfrytëzimi i pakontrolluar si dhe nga ndotja dhe degradimi mjedisor dhe vënies së tyre në dobi të prosperitetit ekonomik të vendit, janë shpallë gjithsej 11 zona me interes të veçantë, të cilat në të ardhmen do të trajtohen si zona në të cilat e drejta për hulumtim apo shfrytëzim do të jepet përmes procedurave konkurruese.

Nga shuma totale e energjisë për mbulimin e nevojave totale të parashikuara, importohen 28% e energjisë bruto në Kosovë. Kryesisht importohen derivate të naftës, energji elektrike, si dhe një sasi e thëngjillit.

Sa i përket PTK-së pas përfundimit të të gjitha procedurave pritet që gjatë vitit 2013 të finalizohet procesi i privatizimit. Sipas Vendimit të qeverisë dhe të Kuvendit biznesi postar është ligjërisht dhe praktikisht i ndarë nga biznesi i telekomit.

Prioritetet për zhvillimin e këtij sektori janë:

Furnizimi i sigurt, i qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë me energji

Realizimi i këtij prioriteti nevojitet që të rritet pjesëmarrja në tregun konkurrues të integruar në sistemet rajonale e që nënkupton edhe arritjen e standardeve ndërkombëtare. Këto dy qëllime të parapara edhe në kornizën strategjike dhe planifikuese për sektorin e energjisë përfshijnë veprime të ndryshme të cilat parashihen të zbatohen edhe me përkrahjen e partnerëve zhvillimor siç janë BE-ja përmes programeve IPA dhe KfW-ja. Kjo do të rezultojë ulje e subvencioneve për import të energjisë elektrike krahas përmirësimit të vazhdueshëm të performancës në KEK. *Politikat e ekzistues* sipas kornizës strategjike dhe planifikuese për sektorin e energjisë përfshijnë aktivitetet të ndryshme si:

- Zbatimi i projektit TC Kosova e Re, në periudhën 2013 -2015.
- Vazhdimi i aktiviteteve për ndërtimin e HC “Zhur” në periudhën 2013-2015;

- Vazhdimi i aktivitetit për dekomisionimin e TC "Kosova A" në periudhën 2013-2015
- Modernizimi i infrastrukturës së sistemit të transmisionit, përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike;
- Fushata promovuese për BRE dhe EE;
- Matja dhe vlerësimi i potencialit të energjisë gjeotermale në Kosovë;
- Auditimi energjetik i ndërtesave publike dhe ndërmarrjeve të tjera të obligueshme;
- Matja dhe vlerësimi i potencialit të energjisë se erës.

Në politikat e reja janë paraparë të përfshihen disa nga këto fusha si: rregullimi sekondar në projektin Kosovë–Shqipëri dhe një numër i projekteve të cilët shërbejnë për përmirësimin e furnizimit me energji.

Nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe përpunimit të resurseve minerale

Realizimi i këtij prioriteti është i paraparë me dokumentet strategjike të zhvilluara dhe të miratuara për këtë sektor. Sigurisht, që hapi i parë është krijimi i një mjedisi të favorshëm ligjor dhe rregullator që do të krijojë bazën për krijimin e kushteve të favorshme për shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të resurseve minerale dhe tërheqje të investimeve; rritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin mineral, krijimi i laboratorit të Institutit Gjeologjik të Kosovës dhe ngritja e kapaciteteve të tij; mundësitë dhe mënyrat e rikultivimit të deponive dhe vendburimeve të shfrytëzuara minerale, gjithashtu do të punohet në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në Trepçë, vazhdimin e punimeve në Minierën e Re (Sibovci) të linjitet.

Veç kësaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik në përkrahje të këtij prioriteti parasheh veprime të reja që kanë të bëjnë me digjitalizimin e të dhënave të sektorit mineral; hapjen e zonave minerale me interes të veçantë për eksplorim, interpretimi i të dhënave gjeofizike ajrore për përcaktimin e zonave potenciale për hulumtimet gjeologjike në Kosovë, mikrozonimi sizmik i Pejës e Mitrovicës dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese në Trepçë.

Reformimi dhe ristrukturimi i NP-ve dhe ngritja e nivelit të shërbimeve publike për qytetarët. Edhe gjatë kësaj periudhe planifikohet të punohet në monitorimin e funksionalizimit të plotë të ndërmarrjes së re Posta e Kosovës dhe zbatimi i kontratës së privatizimit të PTK-së. Rëndësi të posaçme do të ketë përmirësimi i furnizimit me ujë, rritja e kapaciteteve akumuluese dhe prodhuese për furnizim me ujë të pijshëm përmes investimeve në ujësjellësit regional të mbështetura nga partnerët zhvillimor dhe Qeveria, përkrahja e kompanive publike rajonale për ngritje të kapaciteteve teknike për ofrim të shërbimeve përmes investimeve direkte nga MZHE-ja. Synim i Qeverisë është ulja e vazhdueshme e subvencioneve për ndërmarrjeve publike krahas përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së tyre.

Nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe përpunimit të resurseve frekuencore

Në arritjen e këtij prioriteti parashihen politika dhe veprime që rrjedhin nga strategjia përkatëse për kalimin e rrjetit tokësor televiziv nga teknologjia analoge në teknologjinë digjitale. Objektivë mbetet që ky kalim të bëhet deri në fund të vitit 2015.

2. QEVERISJA E MIRË

2.1 Administrata Publike

Administrata publike ka vazhduar punën për të siguruar ngritjen e performancës së saj në shërbim të interesave të qytetarëve, si një synim i vazhdueshëm, me qëllim të plotësimit të kriterëve për integrim evropian. Ministria e Administratës Publike si bartëse e koordinimit dhe menaxhimit të reformës së administratës publike synon që përmes strategjisë për Reformën e Administratës Publike të sigurojë zbatimin më efikas të reformave, ngritjen e sistemit të decentralizimit të fondeve të BE-së. MAP gjatë periudhës së kaluar afatmesme ka ndërmarrë një sërë veprimesh në zbatim të reformës dhe ka miratuar të gjitha aktet nënligjore që dalin nga legjislacioni i Shërbimit Civil për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Administratës Shtetërore, menaxhimit të financave publike, luftimit të korrupsionit, sigurimit të transparencës dhe ofrimit të shërbimeve efikase për qytetarët. Në përgjithësi viteve të fundit është punuar në plotësimin e kornizës strategjike dhe legjislative për funksionimin e një administrate funksionale. Përveç plotësimeve legjislative tashme kërkohet që reforma të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit dhe në reforma substanciale, si dhe përmirësimi i kushteve të punës në administratë.

Prioritetet për fushën e administratës publike janë:

Krijimi i një shërbimi civil jopolitik, profesional, i bazuar në merita dhe i menaxhuar mirë.

Qëllimi i këtij prioriteti është që të ngrihet cilësia e ofrimit të shërbimeve që iu ofrohen qytetarëve. Për arritjen e këtij qëllimi, ministria është në zbatim të Reformës së Administratës Publike ku do të vazhdohet me procesin e ri-organizimit të ministrive dhe organeve vartëse të tyre, finalizimin e procesit të klasifikimit të vendeve të punës dhe zbatimi i sistemit të ri të pagave dhe gradimeve. Më tej, ngritja e kapaciteteve teknologjike është një politikë tjetër që ndiqet në drejtim të arritjes së këtij sistemi përmes veprimeve siç janë: zhvillimi i sistemit të menaxhimit të informatave të burimeve njerëzore dhe ngritjes së kapaciteteve në Shërbimin Civil të Kosovës sipas kornizës strategjike dhe ligjore për reformën e administratës publike.

Krijimi dhe menaxhimi i infrastrukturës për akomodimin e institucioneve

Kushtet e mira të punës janë një aspekt tjetër i përmirësimit të shërbimeve dhe në këtë drejtim është duke u punuar në një numër projektesh që do të kontribuojnë për akomodim më të mirë të institucioneve si dhe me ndërtimin e objekteve të reja të cilat do të përmirësojnë kushtet e punës në fushën e arsimit, mirëqenies sociale, sigurisë, drejtësisë (për nevoja të institucioneve).¹

¹ Kompleksi Rilindja dhe renovimi i Anekseve B,C dhe D; ndërtimi i ndërtesës përcjellëse të AKI; ndërtimi i ndërtesës së MFSK; Pallati i Drejtësisë; Qendra Protokollare në Blinajë; Ndërtimi i Qendrës Korrektuese (burgut për siguri të lartë) në Prishtinë; Ndërtimi i Objektivit të Prokurorive, SHSK, DMNV në Gjilan; Ndërtimi i Objektivit të Prokurorive, SHSK, DMNV në Ferizaj; Ndërtimi i Qendrës së paraburgimit në Gjilan; Ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit Prishtinë; Renovimi i ish ndërtesave të MFS; Kompleksi i Ri Qeveritar, në Hajvali në afërsi të Prishtinës; Renovimi i Objekteve Qeveritare; Ndërtimi i ndërtesës së IKAP; ndërtimi i ndërtesës së Avokatit të Popullit; Fillimi i punëve në ndërtimin e objektivit të ATK-Dogana në Prishtinë; renovimi i Objektivit të MPJ-së; Ndërtimi i ndërtesës të AKI; Ndërtimi i strehimores për viktimat e trafikimit; Ndërtimi i objekteve të prokurorive SHSK, DMNV Pejë; Ndërtimi dhe projektimi i dy fakulteteve në Mitrovicë; Akomodimi i IRK-ve; Menaxhimi i ndërtesave qeveritare; Hartimi i Standardeve Teknike; Vlerësimi i patundshmërisë së Kompleksit RILINDJA

Ngritja e cilësisë së shërbimeve duke shfrytëzuar kapacitetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Objektiv kryesor për periudhën në vijim mbetet themelimi i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit. Gjithashtu do të vazhdojnë politikat që kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të platformës e-Qeverisja. Në këtë drejtim parashihen një varg veprimesh që kanë të bëjnë me: sistemin telefonik qeveritar (VOIP); arkivimi elektronik i dokumenteve shtetërore, zgjerimi i rrjetit qeveritar në të gjitha komunat e Kosovës, interoperabiliteti, qendra operative e rrjetit, projekti për siguri të të dhënave; ngritja e resurseve për TI dhe avancimi i shërbimeve, projekti për wireless (pa tela) etj.

2.2 Politikat për administratën në nivel lokal

Hartimi i legjislacionit, politikave dhe mbikëqyrja e funksionimit të administratës në nivel lokal bëhet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në këtë drejtim janë hartuar dokumente strategjike, si dhe është punuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimit institucional për ushtrimin me sukses të plotë të kompetencave vetanake dhe të deleguara. Janë zhvilluar mekanizmat administrativ për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga komunat. Ka vazhduar përkrahja e komunave në bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkomunal, si dhe përkrahja financiare në zbatimin e projekteve kapitale që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal të komunave në Republikën e Kosovës. Puna e nivelit qendror të qeverisjes për nivelin lokal gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të bazohet në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2013-2016 e cila është duke u hartuar.

Prioritetet e MAPL-se për administratën në nivel lokal janë:

Gjatë periudhës së ardhshme afatmesme parashihet që MAPL të përqendrohet në rishikimin funksional të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, inventarizimin e akteve komunale dhe harmonizimi i tyre me legjislacionin në fuqi, ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve në komuna, vlerësimi i performancës së shërbimeve të ofruara nga komunat, përkrahja financiare e projekteve kapitale për përmirësimin e shërbimeve dhe ngritjen e infrastrukturës komunale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal përmes nxitjes së bashkëpunimit komunal dhe ndërkufitar, zhvillimi i politikave për nxitjen e inkasimit të të hyrave vetanake lokale, monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në komuna, zhvillimin e kapaciteteve komunale dhe përkrahjen e tyre, si dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal. Gjithashtu zhvillimi dhe zbatimi i projekteve për zhvillim socio-ekonomik lokal dhe rajonal, rishikimi dhe zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar (alokimet 2010-2012 IPA I), hartimi dhe zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar (alokimet 2014-2016 IPA II), hartimi i projekteve për avancimin e proceseve elektronike në komuna bazuar në strategjinë e e-Qeverisjes 2009-2015.

Ndërsa si politika të reja do të jenë analiza e organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, funksionalizimi i mekanizmave për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, funksionalizimi i përdorimit të TIK për monitorimin e aktiviteteve të administratës në komuna: Graçanicë, Klllokot, Ranillug, Partesh, ZAMV, Lepsaviq, Zveçan dhe Zubin Potok (instalimi i programeve përkatëse të TIK-ut).

2.3 Politikat kundër korrupsionit

Një nga prioritetet e Institucioneve të Qeverisë së Kosovës është luftimi i korrupsionit dhe praktikave korruptuese. Qeveria ka krijuar kornizën strategjike dhe legjislationin e nevojshëm si dhe ka themeluar strukturën e nevojshme institucionale për të zbatuar politikën e antikorrupsionit.

Strategjia Antikorrupsion është miratuar nga Kuvendi në muajin shkurt 2013. Agjencia Antikorrupsion është institucioni bartës i zbatimit të strategjisë sidomos në ngritjen e vetëdijes dhe informimit për politikën antikorrupsion, adresimin e rasteve të raportuara, deklarimin e pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Agjencia Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera do të zhvillojnë politikën kundër korrupsionit sipas Strategjisë dhe Planit kundër korrupsionit.

2.4 Të Drejtat e Njeriut

Të Drejtat e Njeriut si të drejta të përgjithshme, të drejtat e grupeve të veçanta dhe të drejtat e pakicave në veçanti gjejnë trajtim të veçantë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Legjislationi i Kosovës në përgjithësi është hartuar në frymën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ka të reflektuar dispozitat e së drejtës ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu korniza institucionale që siguron reflektimin e të Drejtave të Njeriut në politikën shtetërore ashtu si edhe për zbatimin e këtij legjislationi është mjaft e avancuar në Kosovë. Megjithatë zbatimi i këtij legjislationi ende mbetet sfidë për institucionet e Kosovës. Gjithashtu korniza strategjike për këtë fushë është shumë e fragmentuar dhe kërkon qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar.

Rishikimi i strukturave aktuale për të Drejtat e Njeriut në nivelin qendror dhe atë lokal të qeverisjes do të bëhet dhe do të jetë në harmoni me vlerësimet që do të dalin nga Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për përmirësimin e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë, i cili ka filluar të realizohet gjatë vitit 2012. Politikën e avancimit dhe mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut janë pjesë edhe e fushës së integritimit evropian dhe iu përkasin të gjitha institucioneve të Kosovës.

2.5 Menaxhimi i planifikimit strategjik dhe financave publike

Zyra e Kryeministrit, gjegjësisht Zyra për Planifikim Strategjik është bartëse e ndërtimit të sistemit të planifikimit strategjik, koordinimit të hartimit të prioriteteve dhe koordinimit të hartimit të dokumenteve strategjike. Me themelimin e Grupit drejtues për planifikim Strategjik dhe departamentet për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian pothuajse është kompletuar struktura institucionale në nivel qendror dhe në nivel të ministrive. Hapat tjerë në këtë drejtim janë sigurimi i koherencës mes dokumenteve strategjike, vendosja e një kornize të përgjithshme strategjike zhvillimore, ngritja e kapaciteteve për koordinim të planifikimit si dhe fokusimi në monitorim të zbatimit.

Ministria e Financave është bartëse kryesore e fushës së menaxhimit të financave publike. Ministria e Financave analizon dhe siguron parashikimet e zhvillimeve makroekonomike, përgatitjen e dokumenteve kryesore buxhetore, politikat ekonomike dhe fiskale të Qeverisë së Kosovës. Ministria e Financave në vazhdimësi rishikon kornizën makro-fiskale në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe në harmoni me programin me FMN-në që shërben si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve dhe të buxhetit vjetor.

Ministria e Financave aktualisht është duke punuar në përpilimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016 si dokument kyç urë lidhëse ndërmjet prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe buxhetit vjetor për planifikimin dhe alokimin e resurseve dhe planifikimin tre vjeçar të buxhetit të Kosovës. Po ashtu Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës janë duke zhvilluar aktivitetin e tyre në përmbushjen e prioriteteve të identifikuara në Planin Strategjik të Zhvillimit 2010-2015, Strategjinë e Përmbushjes 2012-2015 (ATK), respektivisht Planin Strategjik të Doganës 2013-2015, me qëllim të arritjes së objektivave të identifikuara për të siguruar realizimin e parashikimeve makroekonomike dhe fiskale.

Në përgjithësi Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 2012 ka nxjerrë një vlerësim pozitiv mbi Performancën Makroekonomike të Kosovës që është vlerësuar si i suksesshëm për implementimin e programit SMP. Vlerësimi pozitiv i programit SMP ka mundësuar negociimin e marrëveshjes së re SBA (Stand By Arrangement) me këtë institucion. Si rrjedhojë, Qeveria e Kosovës ka ri-jetësuar programin e ri SBA i cili është në zbatim e sipër.

Politikat që kanë të bëjnë me planifikimin strategjik dhe menaxhimin e financave publike janë:

Avancimi i sistemit të koordinuar të planifikimit strategjik

Qeveria gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të vazhdojë të avancojë sistemin e planifikimit strategjik dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional.

- Hartimi i strategjisë zhvillimore të Kosovës
- Avancimi i mekanizmave të planifikimit strategjik
- Ngritja e kapaciteteve për planifikim strategjik në Qeveri
- Ndërtimi i sistemit për monitorimin e zbatimit dhe vlerësimin të strategjive.

Avancimi i sistemit të planifikimit strategjik do të realizohet me mbështetjen e Komisionit Evropian nën kornizën buxhetore të IPA 2013 prej 2 milion Eurosh.

Avancimi i menaxhimit të financave publike dhe ruajtja e qëndrueshmërisë makro-fiskale

Qeveria gjatë periudhës së ardhme afatmesme 2014-2016 do të fokusohet në politikat kryesore si më poshtë e që kanë të bëjnë me Menaxhimin e financave publike dhe qëndrueshmërinë makrofiskale:

- Implementimi i rregullës fiskale me qëllim të ruajtjes së deficitit buxhetor në nivel prej 2% të BPV-se
- Gjenerimi i kursimeve të brendshme buxhetore

- Ruajtja e nivelit të qëndrueshëm të borxhit publik
- Ruajtja e sistemit të thjeshtë tatimor me orientim të zhvendosjes graduale nga mbledhja e të hyrave në kufi në mbledhjen e të hyrave brenda në vend.

3. SUNDIMI I LIGJIT DHE SIGURIA

3.1 Drejtësia

Bartëse e hartimit të politikave dhe legjislacionit për sistemin e drejtësisë është Ministria e Drejtësisë. Ajo funksionon sipas kornizës ekzistuese strategjike dhe planifikuese në ndërtimin e arkitekturës së mirëfilltë ligjore dhe krijimin e standardeve më të larta për funksionimin e sistemit të Drejtësisë në Kosovë. Ajo ka luajtur rol kyç në koordinimin e shumë aktiviteteve edhe me institucionet dhe degët tjera të pushtetit, për të forcuar sundimin e ligjit në vend.

Po ashtu është punuar shumë në rritjen e performancës së gjyqësorit dhe zbatimit të legjislacionit të ri në fuqi; zbatimi i Ligjit të ri mbi Gjykatat, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka përfunduar dhe është në proces të realizimit të ristrukturimit të gjykatave në pajtim me ligjin për gjykata dhe zbatimin e tij përmes akteve nënligjore për zbatimin e tij. Ka përfunduar emërimi i gjyqtarëve për Gjykatën Supreme, Dhomën e Posaçme, Gjykatën e Apelit, Gjykatat Themelore dhe degët e tyre. KGJK-ja është në fazën e zbatimit të strategjisë shtetërore për lëndët e vjetra të grumbulluara dhe zgjidhjes me kohë të të gjitha lëndëve të evidentuara në Gjykatat e Kosovës. Është bërë strukturimi i të gjithë nëpunësve civil të administratës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Gjykata. Kanë vazhduar investimet në infrastrukturën gjyqësore ku është ndërtuar ndërtesa e Gjykatës Themelore në Gjilan si dhe është në ndërtim e sipër objekti i Gjykatës Themelore në Ferizaj - dega në Shtërpçë.

Duke filluar nga ky vit, në Ministrinë e Drejtësisë do të fillojnë së zbatuari disa projekte të fituara nëpërmjet Programit të IPA-së - 2011, 2012 dhe 2013. Këto projekte do të ndihmojnë jashtëzakonisht shumë këtë ministri në përmbushjen e objektivave të saj të parapara me Planin Zhvillimor Strategjik deri në vitin 2016, si dhe do ta sjellin këtë ministri sa më afër standardeve evropiane.

Projektet të cilat pritet të fillojnë gjatë këtij viti dhe të cilat do të përfundojnë në fund të viti 2016 janë: ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve në Agjencinë për Menaxhimin e pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Forcimi i kapaciteteve të Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë. Përmirësimi në zbatimin e sanksioneve penale, ngritja e kapaciteteve në SHKK dhe SHSK. Fuqizimi dhe modernizimi i shërbimit të forenzikës në Departamentin e Mjekësisë Ligjore duke përfshirë operacionin për personat e zhdukur në Kosovë. Përmirësimi në përafrimin e legjislacionit dhe eliminimin e kolizionit të ligjeve. Mbështetje për çështjet pronësore dhe hartimin e Kodit Civil. Mbështetja për Reformën e Drejtësisë për Fëmijë në Kosovë.

Prioritetet në të cilat Qeveria ka rol në krijimin e politikave dhe legjislacionit, mbështetjen e reformave dhe punës në sektorin e drejtësisë janë:

Krijimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritit evropian

Do të vazhdohet me plotësimin e kornizës ligjore, lehtësimin e punës së gjyqësorit përmes funksionimit të sistemit të noterisë, jurisprudencës, ndërmjetësimit, administratorëve falimentues dhe përmbaruesve privatë, luftimi dhe parandalimi i krimit, i keqpërdorimeve të mundshme nga të ardhurat kriminale nëpërmjet administrimit të pasurisë së sekuestruar ose konfiskimit të cilat gjenerojnë fitime të mëdha, përmirësimi në përafrimin e legjislacionit dhe eliminimin e kolizionit të ligjeve.

Ndërsa politika të reja janë mbështetja për çështjet pronësore dhe krijimi i Avokaturës Shtetërore.

Komisioni Evropian do të përkrahë këtë prioritet nëpërmjet një numër projektesh të përfshira në kuadër të programeve IPA 2011, 2012 dhe 2013. Vlera e këtyre projekteve arrin në rreth 5 milionë euro. Ky sektor do të përkrahët më tutje në kuadër të programeve të Instrumentit të Ri të Para-Anëtarësimit të BE-së (IPA 2).

Avancimi i mëtejshëm i sistemit të ndihmës dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar

Politikat ekzistuese janë: krijimi i kushteve me të sigurta për personelin dhe sigurimi i pajisjeve adekuate për ruajtjen e dosjeve, lëndëve të ndjeshme dhe të besueshme, ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit në MD dhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kompletimi i kornizës ligjore sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar.

Ky prioritet do të përkrahët nga ana e BE-së me projektet për ngritjen e kapaciteteve të stafit të drejtësisë dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Projektet realizohen si asistencë teknike dhe kapin vlerën mbi 3 milionë euro.

Sigurimi i parakushteve dhe administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale

Do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të reja infrastrukturore në Shërbimin Korrektues dhe sprovues të Kosovës dhe rindërtimi i atyre ekzistuese, ngritjen profesionale të stafit korrektues dhe sprovues dhe ndërmarrja e masave në risocializimin e të dënuarve, krijimi i institucioneve të veçanta për ekzekutimin e masave edukuese korrektuese për të mitur në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, ngritja e kapaciteteve institucionale të SHSK-së në mbikëqyrjen e personave të dënuar me MDA dhe atyre që janë të liruar me kusht.

Si projekt i ri do të jetë funksionalizimi i Burgut të Sigurisë së Lartë dhe i dy qendrave të reja të paraburgimit (në Prishtinë dhe Gjiilan) dhe aplikimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike për të dënuarit si dhe funksionalizimi i objektit për të mitur me masë edukative. ndërsa në mjekësi ligjore përveç ngritjes së kapaciteteve kërkohet edhe krijimi i laboratorit të ADN-së i cili do të merret me trajtimin e lëndëve civile.

Shërbimi korrektues dhe sprovues do të përkrahët nga BE-ja nëpërmjet mbështetjes për shërbimin korrektues të Kosovës, përmirësimin e infrastrukturës dhe të ndihmës profesionale dhe përkrahjes për mjekësinë ligjore. Vlera e projekteve arrin në 10 milionë euro.

Politikat të cilat parashihen të aplikohen nga ana e sistemit gjyqësor me qëllim të funksionimit të tij më të mirë janë:

Zhvillimi i një sistemi gjyqësor që do të jetë transparent duke siguruar funksionalizim të plotë të reformës gjyqësore në pajtim me ligjet e aplikueshme

Do të vazhdohet me zbatimin e reformës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor, trajnimin e gjyqtarëve dhe stafit administrativ të Gjykatave dhe KGJK-së.

Përkrahët nga projekti i IPA-s 2010 për mbështetjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial me vlerë prej 2.2 milion euro dhe me kohëzgjatje deri në shtator 2014.

Krijimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të gjykatave me qëllim të plotësisht të nevojave që dalin nga reforma

Do të vazhdohet me ndërtimin e objekteve të gjykatave themelore si në Ferizaj, Pejë, Vushtrri, Novobërdë, etj, dhe sigurimi i inventarit për pallatin e drejtësisë.

Ndërsa pritet të përfshihen në kornizën buxhetore edhe ndërtimi i objekteve të gjykatave themelore në Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë. (Këto vendosen në buxhetin e MAP-it) _

Do të vazhdohet me zhvillimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e lëndëve dhe komunikim dhe aftësimin e përdoruesve të sistemeve elektronike, rishikimin e strategjisë për menaxhimin e lëndëve të vjetra, funksionalizimi i Njësisë për hulumtim dhe analizë, dhe ngritja e kapaciteteve me bashkëpunëtorë profesionalë dhe praktikantë gjyqësorë.

3.2 Fuqizimi i zbatimit të Ligjit

Sundimi i ligjit ndonëse ka shënuar progres kohëve të fundit konsiderohet si një nga sfidat me të cilat përballëtohet Qeveria e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme si bartësi kryesor qeveritar për ruajtjen e rendit dhe ligjit ka përfunduar procesin e ristrukturimit dhe konsolidimit, duke i zgjeruar kapacitetet themelore në sektorët e sundimit të rendit dhe ruajtjen e sigurisë publike. Policia e Kosovës vazhdon të marrë kompetenca nga KFOR-i dhe atë në: menaxhimin e integruar të kufijve, ruajtjen dhe kontrollin e brezit kufitar si dhe në sigurimin e objekteve, monumenteve kulturore dhe fetare. Laboratori i Forenzikës që funksionon në kuadër të Policisë së Kosovës vetëm në vitin 2011 ka bërë ofrimin e shumë llojeve

MPB do të vazhdojë të punojë në:

- Përmirësimin e kriterëve për liberalizim të vizave (ri-integrimi dhe ri-atdhesimi i qytetarëve të Kosovës;
- Pajisja e qytetarëve me dokumente personale – biometrike;
- Qartësimin e funksioneve mes agjencive ekzekutive në aspektin e planifikimit qendror, monitorimit, koordinimit dhe funksioneve operative ndërmjet agjencive ekzekutive.

të shërbimeve forenzike prej diku 1000 ekspertimeve. Për të zbatuar legjislacionin në fuqi Ministria e Punëve të Brendshme është e angazhuar vazhdimisht në ngritjen e efikasitetit për të menaxhuar me sukses situatat emergjente. Si rrjedhojë, MPB-ja është duke punuar intensivisht në sistemimin e të gjitha njërive rajonale dhe komunale të emergjencave në strukturën e MPB-së.

Prioritetet kryesore në punët e brendshme janë:

Luftimi dhe parandalimi i krimit dhe sigurimi i jetës dhe pronës së qytetarëve

Kapacitetet dhe shkathhtësitë kanë rëndësi të madhe në realizimin e këtij prioriteti, prandaj do të vazhdohet me politikat e ngritjes së kapaciteteve në këto fusha:

- luftimin e pastrimit të parasë;
- hetimin e narkotikëve;
- luftimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit;
- shtrirjen e sistemit të inteligjencës në të gjitha nivelet;
- rritjen e kapaciteteve të nevojshme për përgjim ligjor të telekomunikimeve;
- sigurimin e komunikacionit rrugor;
- sigurimin e objekteve/infrastrukturës kritike.

Planifikohet që politikat e reja të përqendrohen në:

- sistemet e integruara të dhënave të Policisë,
- luftimin e krimit kibernetikë,
- anëtarësimin në INTERPOL dhe SELEC,
- ngritjen e kapaciteteve për certifikim në edukimin e lartë për fusha me rëndësi për sigurinë;
- pajisja policore për nevoja të veçanta, pajisje speciale, automjete speciale;
- krijimi i sistemit digjital i radio komunikimit;
- vëzhgimi dhe hetimi i veprave të rënda kriminale dhe qasje në luftimin e krimeve në teknologjinë informative;

Përkrahet nga projekti i IPA 2010 për zbatimin e sigurisë së bazuar në njohje inteligjente me vlerë prej 1.1 milionë euro.

Mbikëqyrja, kontrolli dhe menaxhimi i kufijve

Përveç politikave ekzistuese të aktiviteteve për kontrollin e vijës kufitare, kontrollit të lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve, luftimit dhe parandalimit të aktiviteteve kriminale ndër-kufitare, avancimit të bashkëpunimit policor me shtetet fqinje, gjithashtu do të vazhdohet edhe me krijimin e pikave të përbashkëta të kufirit me vendet fqinje dhe menaxhimi i integruar i kufirit, bashkëpunimi strategjik me FRONTX, projekti i binjakëzimit për menaxhimin e integruar të kufirit dhe lufta kundër trafikimit të drogës me kohëzgjatje prej 30 muajsh (2012-2015).

Përkrahet nga projekti i IPA 2011 për Menaxhimin e Integruar të kufirit dhe luftën kundër trafikimit të drogës me vlerë prej 2 milion eurosh dhe kohëzgjatje deri në gusht 2015.

Menaxhimi i çështjeve të migracionit dhe azilit

Do të vazhdohet aplikimi i regjimit të vizave me shtetet e treta, ndërsa si projekte të reja janë ndërtimi dhe funksionalizimi i Qendrës për të Huaj, anëtarësimi në MARRI, fillimi i inicimit të marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës së azilkërkuesve.

Koordinimi efektiv dhe implementimi adekuat i procesit të ripranimit dhe riintegrimin

Pritet vazhdimi i negociimit dhe hartimit të marrëveshjeve bilaterale për ripranim, decentralizimi i kompetencave në procesin e riintegrimit dhe zbatimi i obligimeve që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizim.

Përkrahet nga Projekti i IPA 2012 për Kthim dhe Riintegrim - Faza e IV me kosto prej 6.2 milion euro dhe kohëzgjatje deri në shtator 2015.

Menaxhimi i situatave emergjente

Do të vazhdohet me politikën ekzistuese:

- ngritjen e aftësisë vepruese,
- kompletimi i infrastrukturës me mjete dhe pajisje të nevojshme si dhe ndërtimi i objekteve për NJPZSH,
- mbështetje të operacioneve të menaxhimit të situatave të prishjes së rendit dhe trazirave publike,
- vazhdimin e bashkëpunimit me Programin IPA të Komisionit Evropian për ngritjen e kapaciteteve.

Planifikohet që politikën e reja të përqendrohen në:

- themelimin e qendrës kombëtare për menaxhimin e situatave emergjente,
- zhvillimin e programit të ushtrimeve dhe vlerësimit të gatishmërisë emergjente në fushën e sigurisë së përgjithshme publike, objektit të zjarrfikjes dhe shpëtimit në Komoran.

3.3 Mbrojtja dhe Siguria

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë kanë vazhduar zhvillimin dhe profesionalizimin e kapaciteteve të plota operationale me qëllim të shfrytëzimit maksimal të kapaciteteve ekzistuese për të garantuar siguri për pronën dhe jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Mbështetja e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe komunitetit në përgjithësi ka qenë dhe mbetet një prej objektivave strategjike dhe prioriteteve të MFSK-së.

MFSK, progresin e zhvillimit të FSK-së e ka vazhduar në fushën e menaxhimit të personelit (shkollimet brenda dhe jashtë vendit, rekrutimin, gradimet, avancimet, medaljet dhe dekoratat);

ngritjen e kapaciteteve për operacione reale; krijimin e kompanive model, krijimin e qendrës së ekselencës për kërkim-shpëtim, thellimin e partneritetit bilateral dhe nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit me shtetet që ende nuk kemi arritur marrëveshje (fuqizimi i partneritetit bilateral me SHBA-të, vendet e BE-së, vendet e rajonit dhe KFOR-in), iniciativat dhe ngjarjet të rëndësishme të ndërlydhura me sigurinë; harmonizimin e planeve të saja strategjike dhe objektivat vjetore në përmbushjen e misionit të saj kushtetues dhe ligjor, aspektin e trajnimeve për operacione paqeruajtëse; ngritjen dhe ndërtimin e vlerave, identitetit dhe vizibilitetit të FSK-së; standardizimin e FSK-së bazuar në standardet e NATO-së (STANAG), vlerësimin dhe matjen e kapaciteteve (gjatë vitit 2012 në bashkëpunim të plotë me NATO-në dhe KFOR-in ka realizuar 2 cikle të vlerësimit të kapaciteteve respektivisht RPP1 dhe RPP2).

Qeveria tashmë është duke bërë rishikimin e sektorit të sigurisë ndërsa prioritetet afatmesme në këtë sektor do të bazohen në dokumentet strategjike dhe planifikuese që dalin nga ky rishikim. Megjithatë, duke marrë parasysh që rishikimi ende nuk është përfunduar korniza aktuale e planifikimit në mbrojtje dhe siguri do të bazohet në prioritetet si në vijim:

Ngritja e funksionalitetit të FSK-së

Ngritja e nivelit operacional të FSK-së, veçanërisht e strukturave të përcaktuara për angazhim në mbështetje të operacioneve brenda dhe jashtë vendit, zhvillimi i forcës së sigurisë të mbështetur nga logjistika e integruar dhe e pajisur plotësisht, e kompletuar me personel, e trajnuar në mënyrë efektive, e vetëqëndrueshme dhe që ndërvepron me strukturat e NATO-së dhe zhvillimi i sistemit të avancuar të edukimit dhe trajnimit.

Ngritja e kredibilitetit të FSK-së

Zbatimi i politikave dhe aktiviteteve për ngritjen e imazhit të FSK-së për përballimin e emergjencave dhe mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë, mjedisit e pasurisë, zbatimi i kornizës strategjike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe politikat për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Avancimi i FSK-së për pjesëmarrje në operacione jashtë vendit

Ngritja, zhvillimi dhe profesionalizimi i forcës për reagim jashtë vendit në operacione të paqes dhe operacione humanitare, sigurimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me bazë mirëbesimi në fushën ushtarake ndërmjet shteteve të rajonit dhe më gjerë, anëtarësimi në organizatat dhe iniciativat rajonale dhe pjesëmarrjen e saj në angazhimet, trajnimet, stërvitjet e rëndësishme të sigurisë në rajon, NATO dhe më gjerë.

4. INTEGRIMET EVROPIANE, POLITIKA E JASHTME DHE ANËTARËSIMI NË INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

4.1 Integrimet Evropiane

Procesi i integritimit evropian është përfshirë në agjendën e Qeverisë së Kosovës që nga viti 2003 kur edhe ka filluar themelimi i mekanizmave institucional për menaxhimin e këtij procesi.

Perspektiva e integrimit të Kosovës në BE dhe qasja e Kosovës në instrumentet e anëtarësimit daton që nga fillimi i Procesit të Stabilizim Asocimit. Megjithëse nuk ka arritur marrëveshje bilaterale me BE-në për arsye politike, Kosova deri më tani ka vazhduar të përmbushë kriteret e integrimit. Progresi më i madh në raportet mes Kosovës dhe BE-së është shënuar me nxjerrjen nga KE të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave për shtetasit e Kosovës në vitin 2012 dhe me hapjen e mundësisë që Kosova dhe BE formalisht të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Bartëse e procesit të menaxhimit, koordinimit dhe monitorimit të procesit të integrimit evropian në Kosovë është Ministria e Integrimit Evropian, ndërsa prioritetet kryesore gjatë periudhës së ardhshme afatmesme për Qeverinë do të jetë negociimi i MSA-së dhe zbatimi i kriterëve që dalin nga kjo marrëveshje.

Qeveria ka prioritet krijimin e qasjes strategjike në menaxhimin e procesit të integrimit. Koordinimi i asistencës së jashtme dhe alokimi i saj në pajtim me prioritetet shtetërore është një nga prioritetet e Qeverisë dhe Ministrisë së Integrimit Evropian. Gjithashtu do të vazhdohet të punohet në avancimin e integrimit në organizatat dhe iniciativat e tjera rajonale.

4.2 Politika e jashtme

Bartëse e politikës së jashtme është Ministria e Punëve të Jashtme. Ajo është një ndër ministritë e reja të Qeverisë së Republikës së Kosovës e krijuar me ligj të veçantë. Prandaj MPJ është në proces të konsolidimit të saj ashtu si edhe në konsolidim të marrëdhënieve me jashtë. MPJ është duke marrë masat dhe duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve për shërbimin brenda Ministrisë dhe në misionet diplomatike e konsullore jashtë vendit. MPJ aktualisht ka një staf prej 103 personave që punojnë në Ministri dhe 100 të tjerë në misione diplomatike e konsullore.

Ministria aktualisht ka nën varësi njëzetënjë (21) misione diplomatike, që janë themeluar nga viti 2008, si dhe pesëmbëdhjetë (15) përfaqësi konsullore.

Republika e Kosovës është njohur formalisht nga 98 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Shumica e shteteve të BE-së dhe NATO-s, anëtarësinë e të cilave Kosova synon, sikurse edhe tre nga katër fqinjët e Kosovës, kanë njohur Kosovën si shtet sovran. Po ashtu, Republika e Kosovës ka forcuar subjektivitetin ndërkombëtar duke nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve ndërkombëtare (mbi 118 marrëveshje) në vitet e fundit. Një numër i madh nismash për lidhje të marrëveshjeve të reja tashmë janë në proces të negociimit ose afër nënshkrimit. Kosova kështu është duke u bërë pjesë esenciale e rrjetës së marrëveshjeve dhe obligimeve multilaterale dhe bilaterale, duke përforcuar paqen dhe stabilitetin në Ballkan.

Në rrafshin e marrëdhënieve dypalëshe ka dominuar nevoja për të avancuar marrëdhëniet kontraktuale dypalëshe në të gjitha fushat dhe për të shtuar numrin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me shtetet që kanë njohur Kosovën. Theks të veçantë i është dhënë forcimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve me shtetet me peshë globale dhe rajonale (Partner Strategjik), që përkrahin shtetin e Kosovës. Ruajtja dhe avancimi i partneritetit strategjik me shtetet e Grupit

Drejtuës Ndërkombëtar (GDN), përkatësisht shtetet e QUINT-it, ka determinuar sigurimin e perspektives evropiane për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale (është arritur sigurimi i Studimit të Fizibilitetit dhe Udhërrëfyesit për Liberalizimin e vizave).

Për sa i përket anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare (përveç anëtarësimeve të deritanishme), proces ky i lidhur ngushtë me njohjen ndërkombëtare të Kosovës, janë hedhur hapa të rëndësishëm në përafrimin e procedurave të aplikimit dhe sigurimit të votave (lobimit) për anëtarësim në organizata të ndryshme politiko-ekonomike dhe agjenci të specializuara, rezultatet e të cilave priten të shihen gjatë periudhës kohore të paraparë në këtë plan.

Prioritetet në politikën e jashtme në periudhën e ardhshme afatmesme janë:

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare

Përveç krijimit të kornizës strategjike për anëtarësim në organizata ndërkombëtare prioritet është avancimi i komunikimit politik me organizata relevante ndërkombëtare, bashkërendimi i aktiviteteve me shtetet partnere për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, përmbushja e kritereve dhe aplikimi për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e specializuara, koordinimi ndërinstytucional për marrëveshjet/organizata ndërkombëtare.

Konsolidimi i subjektivitetit ndërkombëtar dhe fuqizimi i imazhit.

Do të vazhdohet me aktivitete lobuese për rritjen e numrit të njohjeve, vendosja e Partneritetit Strategjik me ShBA dhe shtetet prijëse të BE-së, vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet që kanë njohur Kosovën, rritja e numrit të marrëveshjeve ndërkombëtare, pjesëmarrja dhe organizimi i samiteve, konferenca, forume ndërkombëtare, promovimi i Kosovës dhe fuqizimi i imazhit përmes diplomacisë publike, ekonomike dhe strategjisë digjitale.

Ndërtimi i Partneritetit Strategjik me BE dhe NATO

Në realizimin e këtij prioriteti nevojiten përpjekje në vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale në rrugën drejt integritimeve euro-atlantike. Në këtë drejtim edhe gjatë kësaj periudhe planifikohet të vazhdohet me politikën e bashkërendimit të aktiviteteve në negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Associmit, lobimi politik tek institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare, për avancimin e agjendës evropiane për Kosovën, aktivitete diplomatike për hyrje në Partneritet për Paqe me NATO-në, përfshirja e Kosovës në mekanizmat e sigurisë.

5. Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor

5.1 Arsimi

Arsimi gjatë periudhës së kaluar dhe tani vazhdon të jetë në nivel të lartë të prioritetëve të Qeverisë. Gjatë viteve të kaluara është vazhduar thellimi i reformave arsimore në të gjitha nivelet arsimore të parapara në Planin Strategjik të Arsimit të Kosovës 2011-2016. Është realizuar themelimi dhe funksionalizimi i Universitetit të Pejës si dhe kanë filluar përgatitjet për hapjen e Universiteteve të Gjilanit, Mitrovicës dhe Gjakovës, përgatitja e kurrikulit bërthamë për tri nivelet e arsimit parauniversitar, është kompletuar korniza ligjore, është realizuar me sukses vlerësimi i jashtëm për tri nivelet e arsimit, janë akredituar 100 programe trajnuese; janë trajnuar 19154 mësimdhënës në ECDL; është bërë avancimi i infrastrukturës për minoritete në lëmin e të drejtave të njeriut; është sendërtuar promovimi i nevojës për arsim profesional dhe mësim gjatë tërë jetës; zgjerimi i hapësirës shkollore, ku janë përfunduar 7 objekte shkollore me sipërfaqe rreth 42,580 m²; 27 objekte në proces me sipërfaqe rreth 132,400 m²; ka përfunduar Fakulteti i Edukimit- me sipërfaqe neto 6,350 m², biblioteka-instituti në vazhdim me sipërfaqe rreth 5,000m²; konvikti VII me sipërfaqe rreth 6,200m²; shkolla model në proces me sipërfaqe rreth 5,300 m²; me inventar gjatë vitit 2012 janë furnizuar 7 objekte të reja, si dhe 5 objekte të reja cilat ende nuk janë lëshuar në funksion, 4 anekse dhe 16 objekte të reja të ndërtuara nga niveli komunal.

Ndërsa, për periudhën kohore 2014-2016 Qeveria ka përcaktuar prioritetet si në vijim:

Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe i barabartë për të gjithë nxënësit.

Politikat drejt realizimit të këtij prioriteti përfshijnë themelimin e Agjencionit për Kurrikula, Vlerësim dhe Standarde (AKVS) si trup këshillëdhënës i MASHT-it, zhvillimi dhe përkrahja e sistemit të Edukimit Parashkollor që inkurajon përmirësimin e qasjes e të rrjetëzimit të nismave publike e private; zvogëlimi i numrit të ndërrimeve në shkolla përmes ndërtimit të shkollave të reja fillore dhe të mesme; zhvillimi dhe zgjerimi i shkollimit të mesëm të lartë; fuqizimi i kapaciteteve të udhëheqjes në institucione edukative-arsimore përmes hartimit të programeve për trajnimin e drejtorëve të shkollave; ndërtimi i kapacitetit për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës në nivel shkollor; vazhdimi i procesit të hartimit të kurrikulave lëndore në të gjitha nivelet shkollore; zbatimi i planit të veprimit për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar.

Politikat e reja parashikohet të përfshijnë këto fusha: shtimin e numrit të inspektorëve dhe ngritjen e tyre profesionale, funksionalizimin dhe zgjerimin e Agjencionit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit të të rriturve, dhe rritjen e numrit të stafit.

Gjatë periudhës afatmesme, përkrahja për këtë prioritet do të jepet nga ana e USAID-it si asistencë teknike me vlerë 7 milionë euro, ku fokusi është te arsimi në nivelin komunal.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Korniza e Kurrikulit të Kosovës do të jetë baza për realizimin e këtij prioriteti. Në kuadër të kësaj, planifikohet vazhdimi i trajnimit të mësimdhënësve me metodologji të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies, zhvillimi dhe zbatimi i programit për studime për arsimtarët e punësuar, përkatësisht avancimi i kualifikimit të mësimdhënësve pa shpëputje nga puna,

monitorimi dhe vlerësimi i programeve trajnuese si dhe koordinimi i aktiviteteve me organizata qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu, planifikohet të shtohen përpjekjet në këtë drejtim përmes përkrahjes të institucioneve arsimore si Fakulteti i Edukimit dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, përkrahja e komunave me grante specifike për Zhvillimin Profesional të Mësimitdhënësve (ZHPM), programi i Avancimit të Kualifikimit të Mësimitdhënësve (AKM) - UP-së, ku gjatë periudhës afatmesme mbetet të financohet me buxhet shtesë në rast se ka në dispozicion.

Komisioni Evropian, në kuadër të programit IPA 2011, si asistencë teknike, do ta përkrahë këtë me 2 milionë euro gjatë viteve 2014-2015.

Rritja e mundësive për Arsim dhe Aftësim Profesional.

Në realizimin e këtij prioriteti parashihet vazhdimi i punës për zhvillimin e kurrikulave për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe zbatimimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Gjithashtu, do të punohet në përmirësimin e qasjes, cilësisë dhe relevancës të AAP në mënyrë që të jetë në harmoni me kërkesat e tregut të punës.

Ky prioritet do të përkrahet nga IPA 2012, ku njëri prej aktiviteteve ka për qëllim përafrimin e arsimit me nevojat e tregut të punës. Shuma e këtij projekti është 2.8 milion euro ndërsa periudha e zbatimit 2013-2016. Zbatimi do të përfshijë marrëveshjen e delegimit me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA).

Ndërtimi i një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të arsimit të lartë cilësor.

Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit efektiv dhe të qëndrueshëm është i rëndësishëm thelbësor për të përkrahur qasjen e barabartë në arsimin e lartë sipas standardeve dhe trendëve në rajon dhe në vendet evropiane. Në këtë drejtim, do të vazhdohet me zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës, lidhja e marrëveshjeve bilaterale dhe sigurimi i bursave për studentë, rritja e pjesëmarrjes dhe sigurimi i qasjes së barabartë në arsimin e lartë, harmonizimi i programeve të studimit me nevojat e tregut të punës, vendosja e standardeve të cilësisë në mësimitdhënie e në kërkime shkencore, sigurimi i një mjedisi funksional për mësimitdhënie, studime dhe kërkime shkencore, avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mobiliteti i personelit, stafit akademik dhe i studentëve.

Gjithashtu, për të arritur qëllimin për qasje të barabartë dhe të lehtë në arsimin e lartë, Qeveria e Kosovës planifikon të veprojë në drejtim të funksionalizimit të Universitetit të Pejës, Universitetit të Gjakovës, Universitetit të Gjilanit dhe Universitetit të Mitrovicës, funksionalizimi i konvikteve të studentëve.

Përkrahja dhe avancimi i procesit të të nxënimit për të gjithë.

Integrimi efektiv i TIK-ut në sektorin e arsimit, si dhe krijimi i qasjeve të reja në mësimitdhënie dhe në nxënie konsiderohen si politika kryesore në realizimin e këtij prioriteti. Në këtë kuadër, do të vazhdohet me krijimin e kornizës ligjore dhe rregullative për mësim elektronik dhe në krijimin dhe sigurimin e infrastrukturës përkatëse të TIK-ut.

Krijimi dhe sigurimi i infrastrukturës përkatëse të TIK-ut mbështetet nga projekti IPA 2013 “Përkrahje TIK-ut në fushën e arsimit - Faza II” që do të zbatohet gjatë periudhës 2014-2016 me një vlerë prej 1.8 milion euro. Zbatimi bëhet në formën e kontratës së shërbimeve dhe furnizimeve.

Kjo fushë pjesërisht përkrahet nga ADA, nëpërmjet projektit “Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të Fakultetit të Edukimit në Prizren dhe Mitrovicë nëpërmjet TIK për periudhën 2011-2014”.

5.2 Kultura, rinia dhe sporti

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2012-2013, në fushën e kulturës ka vazhduar me përkrahjen e institucioneve vartëse të kulturës, investime kapitale, plotësimin e infrastrukturës ligjore, subvencionimin e kulturës së pavarur, promovimin e skenës sonë kulturore në ngjarjet e mëdha të kulturës në botë si dhe lidhjen e bashkëpunimit me shtete të ndryshme, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e kulturës.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore përmes programit të intervenimeve emergjente në objektet e trashëgimisë kulturore, hartimin e studimit të fizibilitetit për turizmin kulturor dhe natyror, valorizimin dhe inventarizimin e Listës së Përkohshme të Trashëgimisë Kulturore për vitin 2012, udhëzuesin për Konservim të Integruar, si dhe zbatimin e Programit për Masa Preventive për vitin 2012.

Në kuadër të fuqizimit të mekanizmave institucional për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes është vazhduar me themelimin e Këshillave Lokal për Veprim Rinor, konsolidimin e Këshillit Qendror të Veprimit për Rini si dhe përkrahjen e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit të të rinjve në aktivitete rinore rajonale dhe evropiane, ngritjen e kapaciteteve të organizatave rinore si dhe subvencionimin e aktiviteteve të Këshillit Qendror të Veprimit për Rini, Këshillave Lokal për Veprim Rinor, qendrave rinore dhe organizatave joqeveritare rinore. Miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Rini është ndër angazhimet e rëndësishme të realizuara në këtë periudhë.

Në lëmin e sportit ka vazhduar mbështetja për investimet në infrastrukturën sportive siç janë: palestrat sportive, poligonet sportive shkollore dhe stadiumet regjionale të futbollit. Janë subvencionuar Komiteti Olimpik i Kosovës dhe federatat sportive në drejtim të ndërkombëtarizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të tyre, si dhe është punuar në masivizimin e sportit, përmes mbështetjes së sportit shkollor. Në kontekst të zhvillimit të së drejtës së autorit arritje të rëndësishme janë miratimi i Strategjisë kundër Piraterisë dhe Falsifikimit, miratimi i Rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në fushën e të së Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta si dhe themelimi i Task Forcës kundër Piraterisë dhe Falsifikimit.

Prioritetet në kulturë, rini dhe sport:

Përkrahja e institucioneve publike të kulturës, përkrahja e kulturës së pavarur si dhe avancimi i diplomacisë kulturore

Politikat prioritare ekzistuese që parashihen të vazhdohen për arritjen e këtij objekti janë: subvencionimi i institucioneve të kulturës, mbështetja e kulturës së pavarur dhe përkrahja e diplomacisë kulturore.

Ruajtja, promovimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Politikat prioritare ekzistuese që parashihen të vazhdohen për arritjen e këtij objekti janë: vendosja e standardeve profesionale dhe trajnimet, ndërmarrja e nismave dhe mbështetja e aktiviteteve promovuese për trashëgiminë kulturore, hartimi i planeve të menaxhimit të aseteve të trashëgimisë kulturore në kuadër të planeve zhvillimore, ndërmarrja e masave preventive/ndërhyrjeve emergjente.

Fuqizimi dhe integrimi i të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe në politikëbërje

Politikat prioritare ekzistuese që parashihen të vazhdohen për arritjen e këtij prioriteti janë: ngritja e kapaciteteve të organizatave rinore, këshillave të veprimit për rini dhe qendrave rinore; mbështetja e sektorit rinor komunal, rrjetëzimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Politika prioritare e re që parashihet për arritjen e këtij prioriteti është përkrahja e ndërmarrësisë tek të rinjtë.

Zhvillimi dhe avancimi i sportit cilësor, masivizimi dhe ndërkombëtarizimi i sportit, si dhe modernizimi i infrastrukturës sportive

Politika prioritare ekzistuese që parashihet të vazhdohet për arritjen e këtij prioriteti është investimi në infrastrukturën sportive.

Fuqizimi i sistemit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

Politikat prioritare ekzistuese që parashihen të vazhdohen për arritjen e këtij objekti janë: zbatimi i strategjisë kundër piraterisë dhe falsifikimit, promovimi i të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, bashkëpunimi me institucionet vendore të pronësisë intelektuale dhe shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave, anëtarësimi në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

6. SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

6.1 Shëndetësia

Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar me përgatitjet e domosdoshme për reformimin e sistemit shëndetësor i cili me veçoritë organizative të një sistemi që reflekton rrethanat emergjente të pas luftës qëmoti nuk është në gjendje t'u përgjigjet sfidave të kohës, gjë që në mes të tjerave ka

rezultuar me humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin publik të shëndetësisë si dhe largimin e ekspertëve të rinj jashtë vendit.

Hapat e parë të reformës në sistemin shëndetësor kanë rezultuar me përgatitjen e pakos reformuese legjislative në koordinim të ngushtë dhe harmonizim të plotë me partnerët relevant ndërkombëtar si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe duke shfrytëzuar shërbimet konsultative të Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, OBSH, OSBE, ICO, dhe UNICEF. Reforma është e përqendruar në tri shtylla:

- riorganizimi i sistemit shëndetësor;
- sigurimi i financimit të qëndrueshëm të sektorit shëndetësor, dhe
- decentralizimi i menaxhimit të resurseve profesionale – njerëzore në shëndetësi.

Reforma e sistemit shëndetësor do të ketë për qëllim kryesor përmirësimin e cilësisë dhe vëllimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët dhe do të zhvillohet në dy faza:

- Reforma strukturore dhe organizative të sistemit shëndetësor që ka filluar me miratimin e Ligjit të Shëndetësisë në Kuvendin e Kosovës më 13 dhjetor, 2012 dhe;
- Reforma e sistemit të financimit të sektorit shëndetësor, që do të fillojë me miratimin e Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore pas dakordimit paraprak me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Krahas themelimit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë me ligj të veçantë i cili është miratuar në dëgjim të parë në Kuvendin e Kosovës, ndër strukturat kryesore bartëse të reformës janë:

- Agjencioni i Financimit të Shëndetësisë si organ i pavarur i Ministrisë së Shëndetësisë (parardhës i Fondit Publik të Sigurimeve Shëndetësore); dhe,
- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, si institucion shëndetësor me rëndësi të veçantë publike, me shkallë të lartë të autonomisë menaxheriale dhe profesionale, që do të integrojë shërbimet klinike dhe spitalore në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, që fillimisht do të kontraktohen nga Agjencioni për Financimin e Shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe më pastaj edhe nga Agjencionet e Sigurimeve Shëndetësore, publike dhe private, në vend dhe jashtë tij.

Synim strategjik është akreditimi ndërkombëtar i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe kontraktimi i shërbimeve të tij nga Fondet (Agjencionet) e sigurimeve shëndetësore të shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe shteteve të tjera perëndimore për kosovarët që jetojnë në këto shtete, të cilët janë të siguruar në to.

Të gjitha këto zhvillime reformuese në sektorin e shëndetësisë ngërthejnë në vete nevojën e përgatitjes së Strategjisë Sektoriale Shëndetësore 2014-2020 për çka është themeluar grupi i punës. Ky dokument do të shërbej si udhërrëfyes politik dhe profesional në zhvillimin e sektorit të shëndetësisë me vizion që të përmirësoj gjendjen shëndetësore të popullatës në pajtim me misionin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Politikat prioritare të Qeverisë për periudhën afatmesme 2014-2016 në sektorin e shëndetësisë përfshijnë si vijon:

Përmirësimi i menaxhimit të resurseve ekzistuese njerëzore dhe teknologjike.

Do të vazhdohet të punohet në politikat ekzistuese të cilat përfshijnë përmirësimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, forcimin e kapaciteteve të shërbimeve emergjente në Kosovë; zhvillimin e kapaciteteve profesionale në politika dhe menaxhment shëndetësor; zbatimin e planit institucional të zhvillimit të MSh-së, vlerësimin e nevojave të ardhshme të burimeve njerëzore dhe themelimi i planit edukativ; forcimi i inspektoratit shëndetësor, inspektoratit farmaceutik me inspektorë; përmirësimi i kujdesit shëndetësor spitalor me specialist të rinj; përmirësimi i qasjes në kujdesin parësor shëndetësor në viset rurale me mjek të rinj.

Ndërsa planifikohen politikat e reja: ndërtimi i qendrës emergjente të qendrës klinike universitare të Kosovës, renovimi i klinikës së ortopedisë dhe kirurgjisë spinale të (QKUK).

Zhvillimi i sistemit të financimit të qëndrueshëm të sektorit të shëndetësisë

Ndër politikat ekzistuese që Ministria e Shëndetësisë është duke zbatuar janë: themelimi i agjencionit të financimit të shëndetësisë si paraardhës i fondit të sigurimeve shëndetësore dhe ngritja e kapaciteteve të tij

Planifikohen politikat e reja që përfshijnë integrimin e sistemit të informimit shëndetësor me agjencionin e financimit të shëndetësor dhe agjencionin kosovar për produkte medicinale.

Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së përgjithshme të popullatës.

Do të vazhdohet me implementimin e politikave ekzistuese që përfshijnë themelimin e sistemit për sigurinë e cilësisë dhe akreditim të të gjitha institucioneve shëndetësore, përmirësimin e vazhdueshëm të programit të zgjeruar të imunizimit, përmirësimin e zbatimit të shërbimeve të mjekësisë familjare në të gjitha komunat, zbatimin e programit kombëtar për parandalim dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse, përmirësimin e gjendjes së shëndetit oral sidomos tek gjeneratat e reja; zhvillimin dhe zbatimin e programit kombëtar të nutricionit, përmirësimin e kujdesit shëndetësor nëpër komunitete me vulnerabile, themelimin e odës shëndetësore më katër urdhra profesional.

Planifikohen investime në zhvillimin e disa politikave të reja si: parandalimi, zbulimi i hershëm dhe trajtimi i sëmundjeve malinje nëpërmjet themelimit dhe funksionalizimit të shërbimit kombëtar të onkologjisë që do të zhvillojë programe ndërlidhëse me institucionet shëndetësore në nivelin e kujdesit parësor shëndetësor.

6.2 Mirëqenia Sociale

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale vazhdon me forcimin e kornizës ligjore nga fusha e punësimit dhe e politikave sociale, me qëllim të ofrimit të shërbimeve profesionale, sipas praktikave me të mira ndërkombëtare. Niveli i lartë i papunësisë ka ndikuar që numri i kërkuesve për mbrojtje të veçantë sociale dhe asistence sociale të jetë shumë i madh në Kosovë.

Qeveria në vazhdimësi ka ofruar mbrojtje të veçantë për të gjithë qytetaret pa dallime etnike, fetare, gjinore e racore, nga fëmijët e deri tek të moshuarit pa përkujdesje familjare.

Përveç asistencës së dhënë deri më tani, së fundi ka filluar pagesa e shtesave të fëmijëve për familjet e përzgjedhura në ndihmë sociale, ndërsa vlera e pensioneve kontribut pagues nga 01 janari 2013 është ngritur në lartësi 40%. Po ashtu pensionet bazë dhe pensionet e aftësisë së kufizuar nga 01 janari 2013 janë ngritur në vlerën 33,3%.

Është duke u punuar për ripërtëritjen e marrëveshjeve sipas konventave ndërkombëtare të sigurimit pensional invalidor, ashtu si në vitin e kaluar ku ka zhvilluar negociata të vazhdueshme me zyrtarët kompetentë të Austrisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi për arritjen e marrëveshjeve në këtë sferë.

Gjatë vitit 2012 të drejtën në pensione nga Skema e DFDIL-së e kane realizuar gjithsej 13.232 persona. Po ashtu sikur edhe viteve të kaluara, ka vazhduar rehabilitimi i invalidëve, veteranëve dhe i familjeve të dëshmorëve në institucione rehabilituese.

Politikat prioritare në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale janë:

Rritja e mirëqenies sociale përmes ofrimit të mbështetjes për familje në komunitet dhe puna në drejtim të zvogëlimit të varfërisë në Kosovë

Do të vazhdohet me zbatimin e ndryshimeve të Ligjit të Skemës së Ndihmës Sociale, për mbështetjen e familjeve të varfra dhe krijimi i mekanizmave tjerë për një targetim më të mirë të familjeve që jetojnë në varfëri, zhvillimi i programit të aktivizimit për punësim dhe trajnime profesionale, për përfituesit nga kategoria e II-të e skemës së asistencës sociale.

Zbatimi i skemës së përkrahjes së familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuar 1-18 vjeç dhe strehimit familjar për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijë të braktisur

Funksionalizimi i Sistemit të Integruar të TI-së, duke informatizuar të dhënat përmes digjitalizimit të aplikacioneve dhe dokumenteve përcjellëse për secilin klient që kërkon shërbime të ndryshme sociale.

Zbatimi i programit të mbështetjes së strehimoreve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit,

Ndërtimi i shtëpive me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuar të rritur dhe fëmijë.

Ndërtimi i shtëpive me bazë në komunitet për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

Mbështetja dhe krijimi i qendrave ditore për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta.

Mbështetja dhe krijimi i qendrave ditore për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

Ofrimi i shërbimeve në shtëpi-familje për kategorinë e personave me nevoja të veçanta, përmes kontraktimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJQ-ët

Ofrimi i shërbimeve në shtëpi-familje për kategorinë e personave me nevoja të veçanta, përmes kontraktimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me OJQ-ët

Zbatimi i programeve të trajnimit para dhe pas licencimit për punëtorët social, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorëve tjerë relevant për të siguruar efektivitetin në ofrimin e shërbimeve sociale.

Në raport me kompetencat e komunave pritet bëhet transferimi i kompetencave për menaxhimin e shërbimeve në komunitet dhe shërbimeve ditore për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuar.

Kjo fushë do të përkrahë nga programi i IPA 2012 – “Përkrahje shërbimeve sociale” në vlerë prej 2 milion euro që do të zbatohet në vitet 2013-2016.

Përkrahja e invalidëve, familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe kategorive tjera të luftës si dhe përfshirja dhe integrimi i tyre.

Sistemi pensional tri shtyllash, i drejtë, funksional, me burime të qëndrueshme financiare, i cili i plotëson kërkesat nga drejta e sigurimeve sociale, për të gjitha kategoritë e pensioneve.

Në planin afatmesëm do të bëhet edhe zbatimi i Ligjit për Veteranet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Ligjit për ish të Burgosurit Politikë.

Politikë e rëndësishme në kuadër të këtij sektori është shqyrtimi i mundësisë së gjenerimit të kursimeve në skemat ekzistuese pas integritimit elektronik të bazës së të dhënave MPMS dhe ATK.

6.3 Mbrojtja e mjedisit jetësor

Kualiteti i mjedisit në Kosovë është larg standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian. Ekzistojnë probleme serioze në lidhje me cilësinë e ujërave, menaxhimin e mbeturinave, ndotjes së ajrit, ndotjes së tokës dhe humbjes së llojllojshmërisë biologjike, menaxhimi i dobët i mbeturinave industriale dhe shfrytëzimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore. Përveç këtyre, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave është çështje shumë e rëndësishme. Ndotja e ajrit është një çështje tjetër e rëndësishme e cila është e pranishme sidomos në qytetet e mëdha dhe në zonat industriale. Probleme tjera të mjedisit shkaktohen nga zhvillimet e paplanifikuara, mungesa e planeve hapësinore duke përfshirë edhe planet urbane, mungesa e hartave topografike dhe nevoja për shpronësim.

Prioritetet dhe politikat për zhvillimin e këtij sektori janë:

Përmirësimi i gjendjes së mjedisit

Projektet prioritare që mbështesin politikat ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit janë: ndërtimi i një objekti për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme; pastrimi i Lumit Lepenc nga mbeturinat e azbestit; përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave. Këto politika mbështeten nga: Projekti i Programit IPA 2013 - për menaxhimin e mbeturinave; Projekti nga Raundi i VII i WBIF - që ka të bëjë me forcimin e

menaxhimit të mbeturinave, Projekti nga Programi IPA 2010 - rreth përkrahjes institucionale për MMPH-në për ngritjen e kapaciteteve për dhënien e lejeve (Binjakëzim).

Menaxhimi i resurseve ujore

Projekte prioritare që mbështesin politikat ekzistuese për menaxhimin e ujërave janë: rregullimi shtratit të lumit Mirusha në Gjilan; sistemi i ujërave të zeza dhe projekti i përmirësimit infrastrukturor për lumin Bistrica në Prizren, akumulimi i ujit/liqe në lumin Ibër në Mitrovicë, punimi i kanalit derivues për mbrojtjen e moseutrofikimit të liqenit të Radoniqit, studimi i fizibilitetit për mbrojtjen e kanalit të Ibërit, gjelbërimi dhe rehabilitimi i një pjese të parkut industrial në Mitrovicë (rreth lumit).

Fuqizimi i planifikimit hapësinor, banimit, ndërtimit, administrimi të tokës dhe zhvillimi i kadastrës-

Për arritjen e këtij prioriteti politikat prioritare ekzistuese që parashihen të vazhdohen janë: Rikonstruimi i kadastrit, krijimi i kadastrit së përçojave dhe objekteve nëntokësore, hartimi i planeve rregulluese urbane në komunat e Kosovës.

Shpronësimi i pronave për qëllime të interesit të përgjithshëm publik dhe dislokimi i Fshatit Hade.

8. Diaspora

Republika e Kosovës ka një Diasporë të madhe ndërmjet 800 mijë deri 1 milion banorë ose 1/3 e popullsisë jeton jashtë vendit. Megjithatë për shkak të mungesës së një regjistri të Diasporës mungojnë të dhënat e sakta si nga aspekti i numrit ashtu edhe i shtrirjes së tyre. Sipas burimeve të Bankës Botërore rreth 700 milionë euro janë remitenca vjetore. Përgjegjëse për politikat qeveritare rreth diasporës është Ministria e Diasporës. Ministria, përveç aktiviteteve që lidhen me diasporën, deri më tani ka punuar edhe në kompletimin e kornizës ligjore, si dhe është duke hartuar kornizën strategjike për të fokusuar punën e saj gjatë periudhës së ardhshme afatmesme.

Për të realizuar misionin e saj, MeD për periudhën afatmesme planifikon të përqendrohet në:

Politikat në shërbim të diasporës do të vazhdohen në drejtim të zhvillimit dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve, mbështetjes në ruajtjen e identitetit, organizimin e mësimit plotësues, nxitjes së investimeve të diasporës në vend, etj.

Projektet dhe aktivitetet në këtë fushë në planin afatmesëm janë: në periudhën e ardhme afatmesme parashihet krijimi i regjistrit të diasporës, vazhdim i hapjes së Qendrave Kulturore të Kosovës në Diasporë, hapja e seksionit të muzeut të Diasporës dhe Mërgatës në Kosovë, në kuadër të Muzeut Kombëtar, etj.

9. Kthimi dhe komunitetet

Bartëse e politikave dhe aktiviteteve të Qeverisë që kanë të bëjnë me kthimin dhe komunitetet është Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve. Gjithashtu Zyra për Komunitete në kuadër të kabinetit të Kryeministrit ka përgjegjësi në këtë fushë. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka hartuar Strategjinë për Komunitete dhe Kthim 2009-2013 e cila është nënshkruar nga ana e Qeverisë, ndërsa politikat për krijimin e kushteve për kthim dhe ri-integrim në Kosovë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur zhvillohen në bazë të kësaj strategjie.

Për realizimin e këtij vizioni, strategjia fokusohet në tri synime primare që në veçanti janë komuniteti stabil, kthimi i qëndrueshëm dhe ri-integrimi i personave të zhvendosur si dhe riintegrimi ekonomik i komuniteteve. Ajo mundëson që drejtimi i politikave të strategjisë të sigurojë ekzistimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm, integrim në shoqërinë e Kosovës.

Qeveria, respektivisht MKK-ja, aktualisht është duke hartuar Strategjinë për Kthim dhe Komunitete 2014-2018. Duke marr parasysh që kjo Strategji është në hartim e sipër, prioritetet afatmesme të Qeverisë në këtë fushë janë si në vijim:

Ndërtimi i së paku 250 shtëpive bëhet në kuadër të projektit në programin IPA, "Kthimi dhe riintegrimi në Kosovë IV" (RRK IV) për komunat e përfshira (periudha e implementimit të projektit 2013-2015) - shuma totale e projektit 6 mil. Euro (2 mil. MKK, 4 mil. IPA fonde).

Në kuadër të programit të IPA 2013, projektet "Rivendosja dhe riintegrimi i familjeve RAE në Mitrovicë (Iniciativa për Mbështetjen e komunitetit RAE faza II) "si dhe "Programi i Mbështetjes së Rivendosjes për të kthyerit nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republikës së Malit të Zi"- shuma totale e projektit 3.7 mil. Euro (0.37 mil. MKK, 3.3 mil. IPA fonde).

Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur nga Kosova

Do të vazhdohet me ndërtimin e së paku 60 shtëpive çdo vit ndërtimin e 60 shtëpive për të kthyerit si dhe zhvillimi i projekteve infrastrukturore, lehtësimi i kthimit të familjeve të zhvendosura pakicë, ndërtimi i shtëpive me infrastrukturë përkatëse si dhe ndërmarrja e masave socio-ekonomike.

Riintegrimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë

Do të vazhdohet me mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve, përmes zhvillimit të ekonomisë së vogël dhe biznesit familjar, furnizimit me material ndërtimor për familjet të cilat nuk kanë pasur mundësi financiare të rindërtojnë shtëpitë e tyre, ku këto politika kanë për bazë stabilizimin, riintegrimin e komuniteteve dhe zhvillimin e qëndrueshmërisë ekonomike të komuniteteve pakicë si dhe ndarja e pakove të harmonizuara të ndihmave (asistenca humanitare) me rastin e kthimit të PZH-ve (ushqim, mobile, teknikë, lëndë djegëse dhe ndarja e granteve), përkrahja e projekteve të cilat janë në funksion të kthimit, riintegrimit dhe stabilizimit të komuniteteve dhe ndarja e granteve për OJQ-të.

Përkrahje do të ofrohet nga projekti i IPA 2013 për Kthim dhe Riintegrim të Komuniteteve Minoritare me vlere 3.7 milion euro dhe kohëzgjatje deri në qershor 2015.